Zgjidhjeve që u pranuan në LPP i parapriu një analizë komparative e legjislacionit penal-procedural të Gjermanisë, Italisë, Francës, Norvegjisë, Holandës, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Serbisë, sa i përket procedurave të thjeshtësuara dhe të përsheptuara, sipas së cilës u pa se tanimë nuk ekziston një procedurë penale pastër kontinentale. U konstatua se përpjekjet për përsheptim të së drejtës penale përfshijnë pranimin e modeleve të veprimit më të thjeshtë, ku ka tendencë për sjellje të aktgjykimit në fazë më të hershme të procedurës penale, si dhe insistohet që palët të pajtohen për sanksionin penal dhe t'i iket shfrytëzimit të mjeteve ligjore, në ç'mënyrë në tërësi do të përsheptohej procesimi dhe sjellja e aktgjykimeve përfundimtare dhe ekzekutive gjyqësore.<sup>7</sup> Njëkohësisht, vërehet një trajtim i ndryshëm i procedurës për marrëveshje për pranim të fajit sa i përket dënimin, sipas propozimit të palëve dhe të mbrojtësit, dhe deklaratës për pranim të fajit, varësisht nga stadi në të cilin gjendet procedura kur zbatohen këto institute, kompetenca e gjyqit dhe procedura për shqyrtimin, vlerësimin dhe sjelljen e vendimit përfundimtar.

Marrëveshja dhe pranimi i fajit çojnë drejt ridefinimit të plotë të rolit të subjekteve të procedurës, para së gjithash, të palëve dhe të mbrojtësit. Për herë të parë mundësohet dispozita e vullnetit të palëve dhe të mbrojtësit, gjegjësisht gatishmëria e të akuzuarit për ta pranuar fajin, të jetë kusht për shmangie nga procedura klasike penale, në ç'rast racionalizimi dhe përsheptimi i dukshëm i saj, dhe e gjithë kjo të mundësojnë përmbushjen e së drejtës penale.

<sup>6</sup> Recommendation No. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice.

<sup>7</sup> Buzharovska/Nanev/Misoski, Hulumtim krahasues i zgjidhjeve për përsheptim dhe thjeshtësim të procedurës penale, RMDPK, nr. 1/2008.

## 14

### 1.3. Vërejtje kritike

Me qëllim që të fitohet një pasqyrë e qartë për qëndrimet që kanë të bëjnë me marrëveshjen, përveç përparësive, përfitimeve dhe anëve të saj pozitive, duhet të theksohen edhe kritikrat dhe vërejtjet që i bëhen të drejtës me marrëveshje për pranimit të fajit.

Konsiderohet se dobi më të madhe nga ky sistem kanë gjykatësit dhe avokatët, zbutja e dënimit është në kundërshtim me principin e proporcionalitetit të sanksionit, ndërsa legjislacioni penal bëhet sistem hibrid dhe multifunksional.<sup>8</sup>

Marrëveshja për pranimit të fajit konsiderohet si katastrofë në procedurën penale dhe institut që mundëson zbutje të pamërituar të dënimit të të akuzuarit.<sup>9</sup> Ajo ka mungesa kushtetuese-juridike pasiqë i nënçmon garancitë procedurale të të akuzuarit dhe është në kundërshtim me të drejtat e tij: t'i marrë në pyetje dëshmitarët, të gëzojë mbrojtje në bazë të supozimit se është i pafajshëm, të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik<sup>10</sup>.

Përveç kritikave se sanksioni i shqiptuar që ndërlidhet me deklaratën për pranimit të fajit, nuk mbështetet mbi bazat penologjike për dënim, vërejtje serioze ka sa i përket rrezikut për personin e pafajshëm që ta pranojë fajin, rrezikun që të propozohet dënim më i madh se sa ai që do ta shqiptonte gjyqi për rastin e njëjtë pas kryerjes së procedurës penale, si dhe “padukshmërinë” e rasteve ku ka deklarata për fajësi dhe marrëveshje për pranimit të fajit.<sup>11</sup>

## 2. FORMA TË MARRËVESHJES PËR PRANIM TË FAJIT

Edhe përkundër faktit se marrëveshja për pranimit të fajit ka rrënjë të drejta anglosaksone, duhet theksuar fakti se ekziston dallim i madh në mes të motivit për negociata për fajësinë në shtetet me të drejtë zakonore (common law) dhe shtetet evropiane.

<sup>8</sup> Françoise Tulkens, fq. 664.

<sup>9</sup> Stephen J. Schulhofer, Plea Bargaining as Disaster, Yale Law Journal, 1992, 101, çp. 1979-2009. Russell Christopher, The Prosecutors's Dilemma: Bargains and Punishment, Fordham Law Review, 2003, 72, fq. 93-168.

<sup>10</sup> Andrew Ashworth/Mike Redmayne, The Criminal Process, 2005, 3<sup>rd</sup> edition, Oxford University Press, kapitulli 12, theksuar sipas N. Garoupa/F.H. Stephen, fq. 9. Timothy Lynch, The Case Against Plea Bargaining, Regulation, 2003, Vol. 26, No. 3, fq. 24-27.

<sup>11</sup> Robert A. Carp/Ronald Stidham, Judicial Process in America, 2<sup>nd</sup> edition, Washington DC, 1993, fq. 169-170.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 15

Modeli anglosakson i marrëveshjes për pranim të fajit është i orientuar kah vëllimi i akuzës – numri, përshkrimi dhe kualifikimi juridik i veprës penale (charge bargaining), ndërsa legjislacioni evropian e pranon konceptin ku temë e bisedimeve dhe e negociatave është lloji dhe lartësia e sanksionit (sentence bargaining).

Dallime ekzistojnë edhe në mënyrën e përcaktimit gjegjësisht zbatimit – në Angli marrëveshja për pranim të fajit zbatohet një kohë të gjatë, mirëpo formalisht është ligjësuar në vitin 1996, ndërsa në shtetet me sistem të përzier penal-juridik, për shkak të principit të legalitetit, hapi i parë është rregullimi legjislativ i marrëveshjes për pranim të fajit, pas së cilës pasojnë jetësimi dhe zbatimi praktik i saj.

Marrëveshja për pranim të fajit ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij ekziston në shumë sisteme bashkëkohore penale-procedurale, me disa ngjashmëri dhe dallime, varësisht nga vlerësimi i ligjvënësit, gjegjësisht praktikës, për atë se në ç'mënyrë dhe në ç'formë të pranohet marrëveshja për pranim të fajit.

Është evidente ekzistenca e disa formave të marrëveshjes për pranim të fajit, të cilat nuk përjashtojnë njëra-tjetrën dhe mund të kombinohen:

- charge bargaining – marrëveshje për përmbajtjen e aktit të prokurorit sa i përket përshkrimit dhe kualifikimit juridik të veprave penale;
- fact bargaining – pajtueshmëri për prezantim selektiv të fakteve, nëse i akuzuari jep deklaratë për pranim të fajit; dhe
- forma të veçanta të marrëveshjes:
  - nolo contendere pleas – sanksioni pranohet pa dhënie të deklaratës për pranim të fajit në mënyrë të qartë; ka disa përparësi për të akuzuarin, e në fakt i shmanget krijimit të obligimeve për kompensim të dëmit e cila do të mund të ndërliidhej në procedurë civile, që do të pasonte pas përfundimit të procedurës penale në të cilën i akuzuari është deklaruar si fajtor<sup>12</sup>;

<sup>12</sup> I akuzuari as e pranon e as nuk e konteston akuzën; në shumë legjislacione nuk parashihet si e drejtë e të akuzuarit; shërben si alternativë e deklaratës për pranim të fajit dhe shfrytëzohet gjatë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit. Deklarata sipas së cilës i akuzuari nuk i konteston faktet e rastit, mirëpo thotë se assesi nuk ka kryer vepër penale, mund të kuptohet se i akuzuari nuk i kupton akuzat ndaj tij. Kjo deklaratë futet në procesverbal me pëlqim të gjykatësit (në raste të veçanta të prokurorit) dhe ka dy përparësi: a) i akuzuari të thotë se në aspektin formal nuk ka aktgjykim ndëshkues edhe pse është shqiptuar dënimi, dhe b) kjo deklaratë pamundëson që ndaj të akuzuarit të ngritet padi civile për kompensim, R.A. Carp/R.Stidham, fq. 165.

## 16

- alford pleas – paraqet rastin kur i akuzuari nuk e pranon fajin, por deklarohet se prokuroria ka dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm<sup>13</sup>;
- sentence bargaining – pranimi i fajit çon në drejtim të zvogëlimit apo zbutjes së dënimit, gjegjësisht në drejtim të përcaktimit të dënimit me kohëzgjatje më të shkurtër sesa që supozohet se do ta caktojë gjyqi, në rast se do të organizohej procedurë e rregullt gjyqësore.

### 3. MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT SIPAS DISPOZITAVE TË LPP

Duhet të sqarohen në mënyrë të detajuar kushtet për marrëveshje për pranim të fajit, të cilat i ka paraparë ligjvënësi, veprimi i palëve, parashtrimi i propozim-marrëveshjes për pranim të fajit, përmbajtja e saj, aktivitetet e gjyqit, sa i përket vlerësimit të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit dhe roli i palëve, mbrojtësit, të dëmtuarit dhe gjyqit gjatë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit.

#### 3.1. Karakteristikat kryesore të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit

Në LPP është propozuar procedurë për sjellje të aktgjykimit në bazë të marrëveshjes për pranim të fajit në mes të prokurorit publik dhe të dyshuarit, dhe për herë të parë mundësohet marrëveshja midis palëve me qëllim që të arrihet zgjidhje e pranueshme nga të gjitha palët.

Kjo procedurë i ka këto karakteristika themelore:

- **Pesha e veprës penale** – marrëveshja për pranim të fajit lejohet për të gjitha veprat penale, pa marrë parasysh peshën e paraparë të sanksionimit penal;
- **Zbutja e dënimit** – gjatë përcaktimit të sanksionimit penal, gjykatësi kompetent është i obliguar që atë ta përcaktojë sipas llojit dhe lartësisë, brenda kornizave të përcaktuara ligjore për veprën konkrete penale, mirëpo jo nën kufijtë për zbutje të dënimit të përcaktuara me Kodin penal;
- **Pëlqimi nga të dyja palët** – propozim-marrëveshja për pranim të fajit është shprehje e pëlqimit paraprak të të dyja palëve dhe nuk lejohet që me këtë marrëveshje të ngarkohet vetëm njëra palë. Gjatë kësaj, aspak nuk është me rëndësi nga cila palë ka ardhur iniciativa për fillim të procedurës për marrëveshje,

<sup>13</sup> Emrin e ka marrë sipas rastit në Gjyqin Suprem të SHBA-ve, *North Carolina v. Alford*, 400 U.S. 25 (1970).

por është e rëndësishme që te të dyja palët (palët dhe mbrojtësi) të ekzistojë një gatishmëri për t'u kyçur në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit.

- **Kur mund të bëhet marrëveshja për pranim të fajit** – LPP nuk përcakton kufizime sa i përket stadi të procedurës se kur lejohet të bëhet marrëveshja për pranim të fajit, prandaj marrëveshja lejohet në çdo moment mbasi që prokurori publik të sjellë urdhër për fillim të procedurës hetimore e deri kur kryhet vlerësimi i aktakuzës.
- **Modeli i marrëveshjes për pranim të fajit** – ligjvënësi maqedonas ka pranuar model të marrëveshjes për sanksionimin penal (sentence bargaining), e jo për veprat penale që do të përfshihen në akuzë. Në fakt, në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit mund të përfshihen të gjitha veprat penale apo një pjesë e tyre, për të cilat është sjellë urdhri për procedurë hetimore, mirëpo për veprat që përmenden në urdhër për të cilat nuk është arritur marrëveshje, procedura patjetër duhet të vazhdojë.
- **A është pranimi i krimit parakusht për marrëveshje** – deklarata për pranim të fajit nuk është parakusht për fillim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit gjatë procedurës hetimore, gjë që nuk ndodh me marrëveshjen për pranim të fajit në fazën e vlerësimit të aktakuzës, kur pranimi i fajit është parakusht për fillim të procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit.
- **Mbrojtja e të dëmtuarit** – me qëllim që të mbrohen interesat e të dëmtuarit, është paraparë një obligim për prokurorin publik që ka të bëjë me propozim-marrëveshjen për pranim të fajit, që së bashku me të gjitha dëshmitë e siguruara, detyrimisht të bashkangjesë edhe deklaratë me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari sa i përket llojit dhe lartësisë së kërkesës pronësore-juridike. Gjatë marrëveshjes është e mundur që të arrihet pajtueshmëri për një pjesë të kërkesës së të dëmtuarit apo ajo aspak të mos jetë çështje diskutimi gjatë procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, me ç'rast i dëmtuari nuk mbetet pa mbrojtje edhe në rast kur kërkesa e tij pronësore-juridike aspak nuk ka qenë çështje diskutimi apo është pranuar pjesërisht, ai mund të thirret në aktgjykimin e sjellë për shkak të propozim-marrëveshjes së pranuar, si bazë për t'i realizuar të drejtat e tij në kontest civil.
- **Subjekti i marrëveshjes për pranim të fajit** – lloji dhe lartësia e sanksionit që parashihet në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit, në mënyrë të paevitueshme është subjekti i marrëveshjes. Në propozim-marrëveshjen për pranim të fajit duhet të theksohet në mënyrë të saktë sanksioni që propozohet, i përcaktuar për nga lloji dhe lartësia, në kuadër të kornizave të përcaktuara me ligj për veprën konkrete penale, mirëpo jo nën kufijtë për zbutje të dënimit të



përcaktuara me Kodin penal. Kërkesa pronësore – juridike mund të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit vetëm kur i dyshuari ka dhënë pëlqim gjatë procedurës për marrëveshje që të merret parasysh dhe të negociohet për kërkesën pronësore-juridike të të dëmtuarit.

- **Prezenca e detyrueshme e mbrojtësit** – që nga momenti i fillimit të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, i dyshuari patjetër duhet të ketë mbrojtës të cilin do ta zgjedhë vet apo do t'i përcaktohet sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë zgjerohen mundësitë për mbrojtje të detyrueshme gjatë procedurës penale, që ka për qëllim të sigurojë barazi të armëve dhe të pamundësojë që i dyshuari, i cili zakonisht është laik i legjislacionit, të participojë në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit, pa pasur mundësi për mbrojtje dhe vlerësim të një procedure të këtillë si tërësi, që nga fillimi e deri te rezultati përfundimtar.
- **Ndalesa për pjesëmarrje të gjyqit në marrëveshjen për pranim të fajit** – mospjesëmarrja e gjyqit në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit është përcaktuar në mënyrë të prerë, që ka për qëllim t'ia pamundësojë gjyqit që në çfarëdo mënyre të ndikojë mbi palët dhe mbrojtësin, sa i përket vendimit se a t'ia fillojnë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit, si dhe sa i përket zgjedhjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.

### 3.2. Elementet e propozim-marrëveshjes për pranim të fajit

Në LPP janë përcaktuar në mënyrë decide **elementet e propozim-marrëveshjes për pranim të fajit**, të cilat mund të ndahen në disa kategori:

- **të dhëna hyrëse:**
  - të dhëna për pjesëmarrësit në procedurën për marrëveshje për pranim të fajit (prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij); dhe
  - përshkrim dhe kualifikim juridik i veprave penale për të cilat përgatitet propozim- marrëveshja për pranim të fajit (mund të jetë për të gjitha apo për një pjesë të veprave penale për të cilat zhvillohet procedura hetimore).
- **subjekti i marrëveshjes për pranim të fajit:**
  - sanksioni i propozuar sipas llojit dhe lartësisë (dënimi kryesor, dënimi dytësor, masa e sigurisë, masa alternative dhe masa të tjera të parapara në Kodin penal); dhe/ose
  - lloji dhe lartësia e kërkesës pronësore-juridike dhe mënyra e realizimit të saj, nëse i dyshuari ka dhënë pëlqim që ajo të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Kërkesa pronësore-juridike përcaktohet sipas deklaratës që e ka dhënë i dëmtuari dhe futet pajtueshmëria që mund të arrihet, eventualisht, për mënyrën e realizimit të kësaj kërkesë në propozim-marrëveshje.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 19

- **deklaratat e palëve:**
  - deklarata e të dyshuarit se me vetëdije dhe vullnetarisht e pranon propozim-marrëveshjen për pranim të fajit dhe pasojat që dalin nga ajo; dhe
  - deklarata nga prokurori publik dhe i dyshuari se heqin dorë nga e drejta për ankesë nëse sillet aktgjykim me të cilin do të pranohet propozim-marrëveshja për pranim të fajit.
- **mënyra e kompensimit të shpenzimeve të procedurës;**
- **pjesa përfundimtare:**
  - nënshkrim i prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij; dhe
  - data dhe vendi i nënshkrimit të propozim-marrëveshjes për pranim të fajit.

Kur gjyqit do t'i dorëzohet propozim- marrëveshja për pranim të fajit e nënshkruar nga të dyja palët fillon faza e dytë e procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit që ka të bëjë me **vlerësimin gjyqësor të propozim-marrëveshjes për pranim të fajit.**

Duke pasur parasysh faktin se propozim- marrëveshja mund të parashtrohet qysh **gjatë procedurës hetimore**, në procesin e vlerësimit të propozim-marrëveshjes së parashtuar, rol aktiv dhe status të gjykatësit që sjell aktgjykimin në fazën e hetimit ka gjykatësi për procedurë paraprake.<sup>15</sup>

Propozim- marrëveshja shqyrtohet në **seancë** të veçantë, të cilën gjykatësi i procedurës paraprake e cakton në afat prej 3 ditësh nga pranimi i propozim-marrëveshjes për pranim të fajit. Nga afati i përcaktuar në këtë mënyrë rrjedh se ligjvënësi insiston që procedura të zhvillohet shpejt dhe në mënyrë efikase. Në seancë thirren parashtuesit e propozim- marrëveshjes për pranim të fajit, gjegjësisht palët dhe mbrojtësi.

Në seancë, gjyqi fillimisht i **shqyrton** këto rrethana:

- vallë propozim-marrëveshja është parashtuar për pranim të fajit në mënyrë vullnetare;
- vallë i dyshuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të saj;
- vallë i dyshuari është i vetëdijshëm për pasojat që ndërlidhen me kërkesën pronësore-juridike, dhe
- a është i dyshuari i vetëdijshëm për shpenzimet e procedurës.

<sup>15</sup> Veprimi i gjyqit në statet tjera të procedurës, ku parakusht është deklarata për pranim të fajit nga i dyshuari, gjegjësisht i akuzuari, me ç'rast gjyqi fillimisht e vlerëson deklaratën e dhënë, e pastaj propozim-marrëveshjen e parashtuar, është sqaruar më poshtë, në pjesën ku bëhet elaborimi i statusit të deklaratës për pranim të fajit.

## 20

Pas shqyrtimit të rrethanave të lartpërmenduara, gjykatësi i procedurës paraprake është i obliguar **t'i udhëzojë** palët dhe mbrojtësin:

- se mund të heqin dorë nga marrëveshja e parashtruar për pranim të fajit, deri në sjelljen e vendimit nga ana e gjyqit, me ç'rast do të konsiderohet sikur ajo fare të mos ishte dorëzuar dhe të gjitha aktet do të kthehen te prokurori publik për procedurë të mëtutjeshme; dhe
- se pranimi i propozim- marrëveshjes për pranim të fajit konsiderohet heqje dorë nga e drejta për ankesë ndaj aktgjykimit të sjellë me të cilin në tërësi pranohet propozim- marrëveshja e parashtruar.

Palët mund të heqin dorë nga propozim- marrëveshja e parashtruar, me ç'rast **heqja dorë** mund të jetë:

- eksplicite – nëse prokurori publik dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij heqin dorë nga propozim- marrëveshja e parashtruar deri në sjelljen e vendimit; apo
- implicite – nëse prokurori publik dhe i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës parashtrojnë kërkesë për përcaktim të sanksionit që është i ndryshëm nga sanksioni që parashihet me propozim-marrëveshjen për pranim të fajit.

### 3.3. Vlerësim i propozim- marrëveshjes për pranim të fajit

Vendimi i gjykatësit për propozim- marrëveshjen e parashtruar mund të jetë në formë të aktvendimit, gjegjësisht në formë të aktgjykimit, varësisht nga ajo se gjykatësi a e ka vlerësuar atë si të pranueshme apo jo.

Nëse propozim- marrëveshja për pranim të fajit vlerësohet si e pranueshme, gjyqi kompetent sjell **aktgjykim** i cili bazohet në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit dhe gjatë sjelljes së këtij aktgjykimi gjyqi nuk duhet të shqiptojë sanksion penal të ndryshëm nga sanksioni penal që është paraparë në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit. Nga ky përcaktim del se gjyqi nuk guxon të bëjë asnjë lloj ndryshimi në sanksionin e propozuar (dënimi kryesor dhe dënime apo masa dytësore) për se janë dakorduar palët. Nëse konsideroni se sanksioni i propozuar nuk është i pranueshëm si tërësi, silllet një aktvendim për refuzim të propozim-marrëveshjes, pas të cilit aktet kthehen te prokurori (në rast se marrëveshja për pranim të fajit bëhet gjatë procedurës hetimore) gjegjësisht vazhdohet me procedurën (nëse marrëveshja për pranim të fajit është bërë në ndonjë stad të mëvonshëm të procedurës).

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 21

Aktgjykimi që sillet në bazë të propozim- marrëveshjes, i përmban të gjitha elementet e aktgjykimit ndëshkues në përputhje me LPP-në. Ai shpallet menjëherë, ndërsa përpilohet në formë të shkruar në afat prej 3 ditësh pas shpalljes së aktgjykimit.

Aktgjykimi, pa vonesë, u jepet prokurorit publik, të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij, si dhe të dëmtuarit, i cili nëse nuk është i kënaqur me vendimin për llojin dhe lartësinë e kërkesës së miratuar pronësore-juridike, të drejtën e tij mund ta realizojë në procedurë kontestimore.

Me aktgjykimin e sjellë vendoset në mënyrë meritore në rastin konkret penal, dhe ai ka karakter të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe ekzekutiv. Në këtë mënyrë mundësohet përfundim i procedurës në fazën më të hershme të mundshme pas fillimit të saj, ndërsa pamundësia për t'u ankuar ndaj aktgjykimit të sjellë çon në rezultat përfundimtar të shpejtë, efikas, të drejtë dhe të pranueshëm për të dyja palët, që konsiderohet si situatë e jashtëzakonshme në të drejtën penale procedurale.

Vendimi negativ i gjyqit është në formë të **aktvendimit për refuzim të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit** të cilën gjyqi do ta sjellë kur:

- do të vërtetohet se dëshmitë e mbledhura për faktet që janë të rëndësishme për zgjedhje dhe peshim të sanksionit penal nuk e arsyetojnë shqiptimin e sanksionit të propozuar penal të paraparë në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit, ose
- prokurori publik, i dyshuari dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës kanë bërë kërkesë për përcaktim të sanksionit penal që ndryshon nga ai që është paraparë në propozim marrëveshje.

Nuk lejohet ankesë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozim- marrëveshja për pranim të fajit.


Në rast të sjelljes së aktvendimit me të cilin refuzohet propozim- marrëveshja për pranim të fajit, gjykatësi i procedurës paraprake ia dorëzon aktet prokurorit publik, ndërsa procesverbali nga seanca e mbajtur dhe propozim- marrëveshja për pranim të fajit nuk mund të shfrytëzohen gjatë procedurës së mëtejshme, për shkak se ato ndahen në zarf të veçantë, të mbyllur.

LPP nuk përmban asnjë lloj kufizimi sa i përket mundësisë që palët përsëri të parashtrajnë propozim- marrëveshje për pranim të fajit deri në gjyq, pasi ai

22

paraprkisht t'ua ketë refuzuar propozim- marrëveshjen që është vlerësuar si e papranueshme.

## AKTGJYKIMI NË BAZË TË PROPOZIM-MARRËVESHJES PËR PRANIM TË FAJIT



### 3.4. Roli i subjekteve që marrin pjesë në procesin e marrëveshjes për pranim të fajit

Nga *prokurori publik* pritet veprim aktiv në kuptim të inicimit të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit dhe angazhimit për të arritur deri te një sanksion penal që është i pranueshëm nga të dyja palët për veprën apo për veprat për të cilat ai ka sjellë urdhër për fillim të procedurës hetimore. Prokurori publik duhet që fillimisht ta vlerësojë vlerën e dëshmive të mbledhura me të cilat disponon në rastin konkret dhe në bazë të tyre të sjellë vendim se vallë duhet të iniciojë marrëveshje për pranim të fajit, apo do të shfrytëzojë ndonjë mundësi tjetër procedurale që ia ofron LPP-ja, si për shembull, shtyrje të kushtëzuar të ndjekjes penale apo do të zhvillohet procedura e rregullt penale. Në kuadër të autorizimeve të prokurorit publik sipas LPP-së, në mes tjerash, është paraparë edhe detyrimi që ai të negociojë dhe të merret vesh me të akuzuarin për pranim të fajit, në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me LPP. Në drejtim të përcaktimit të rolit të prokurorit publik mund të kontribuojnë edhe aktgjykimet e Gjyqit Suprem të SHBA-ve, ku ekziston një zbatim praktik i suksesshëm shumëvjeçar i marrëveshjes për pranim të fajit. Nga aktgjykimet mund të përfundohet se si obligimet kryesore të prokurorit gjatë procedurës së marrëveshjes për pranim të fajit veçohen:

- ndalesa e dëshirës për hakmarrje;
- roli i garantit dhe i rojtarit të ligjshmërisë; dhe
- vendosja e diskrecionit të plotë e prokurorit sa i përket llojit të veprave penale për të cilat do të bëhet ndjekja apo marrëveshja për pranim të fajit.<sup>16</sup>

*I akuzuari* është njëra nga palët që merr pjesë në procedurën e marrëveshjes për pranim të fajit, e i njëjti mund të paraqitet në rolin e iniciatorit për fillim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit. Sipas LPP-së, i akuzuari ka të drejtë që ta paraqesë lirshëm mbrojtjen e tij, të mos jetë i detyruar të japë deklaratë kundër vetes, të afërmve të tij apo ta pranojë fajin, si dhe të ketë mundësi të deklarohet për faktet dhe dëshmitë të cilat e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe dëshmitë që janë në favor të tij. Nga i akuzuari pritet që të jetë i njoftuar mirë me karakteristikat dhe mundësitë që i ofron marrëveshja për pranim të fajit, por edhe me implikacionet që dalin nga kjo procedurë, siç janë:

- heqja dorë nga e drejta për ankesë;
- mundësia për të hequr dorë nga marrëveshja e parashtruar për pranim të fajit deri sa të silllet një vendim nga ana e gjyqit;

<sup>16</sup> Më detajisht te Buzharovska, G/Misoski, B, Marrëveshja për pranim të fajit dhe ndërmjetësimi, fq. 221.

## 24

- pasojat të cilat do të ndodhnin, nëse në seancën për vlerësimin e propozim-marrëveshjes për pranimit të fajit bën kërkesë për përcaktim të sanksionit të ndryshëm nga ai që është paraparë në propozim-marrëveshje;
- mundësia që të japë pëlqim që kërkesa pronësore-juridike të jetë subjekti i marrëveshjes për pranimit të fajit; dhe
- pasojat që kanë të bëjnë me kompensimin e një pjese të shpenzimeve të procedurës.

Pjesëmarrja e *mbrojtësit* në procedurën për marrëveshje për pranimit të fajit që nga fillimi i saj është e obligueshme. Nga mbrojtësi pritet profesionalizëm, ndihmë kualitative juridike dhe veprim në drejtim të mbrojtjes së interesave të të akuzuarit. Mbrojtësi duhet të jetë me përvojë, i zhdërvjellët dhe i aftë që me prokurorin të merret vesh për sanksionin që është i pranueshëm në aspekt të mbrojtjes, duke pasur parasysh faktin se çfarë do të ishte sanksioni, në qoftë se do të realizohej procedura e rregullt penale. Duke i pasur parasysh këto pritje nga mbrojtësi është plotësisht e qartë se ligjvënësi është përcaktuar për zgjidhje ku nuk mund të realizohet procedura për marrëveshje për pranimit të fajit pa praninë e mbrojtësit. Me dispozitat që kanë të bëjnë me procedurën për marrëveshje për pranimit të fajit zgjerohen mundësitë për mbrojtje të obligueshme, gjegjësisht nëse i akuzuari vet nuk zgjedh mbrojtës, atij t'i përcaktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare nga ana e kryetarit të gjyqit kompetent.

Ndalesa që *gjyqi* të marrë pjesë në procedurën për marrëveshje të pranimit të fajit është theksuar në mënyrë të prerë. Ky përcaktim ka për qëllim të pamundësojë ndikim të gjyqit sa i përket përzgjedhjes së llojit dhe lartësisë së sanksionit penal dhe të potencojë rolin që prokurori publik e ka si dominus litis gjatë procedurës hetimore. Me mospjesëmarrje në procedurën për marrëveshje për pranimit të fajit, gjykatësi e ruan paanshmërinë e tij si arbitër, duke e vlerësuar propozim- marrëveshjen e parashtruar për pranimit të fajit në bazë të dëshmimeve të siguruara nga ana e prokurorisë. Fakti që gjykatësi nuk ka qasje në ecurinë e procedurës për marrëveshje për pranimit të fajit është i dobishëm, meqenëse në këtë mënyrë, gjykatësi nuk ka njohuri për procesin e negociatave që i ka paraprirë nënshkrimit të propozim- marrëveshjes për pranimit të fajit, ai nuk i di bisedat që janë zhvilluar në mes të prokurorit dhe mbrojtësit. Në këtë mënyrë potencohet roli i gjyqit në fazën e dytë të procedurës për marrëveshje për pranimit të fajit. Marrëveshja për pranimit të fajit mundëson dhënie të

aktgjykimit në stad më të hershëm të procedurës dhe në këtë mënyrë aktgjykimi i bazuar në propozim- marrëveshjen për pranim të fajit mund të sillet si në procedurën hetimore, po edhe në fazën e vlerësimit të akuzës. Dispozitat që kanë të bëjnë me marrëveshjen për pranim të fajit zbatohen edhe atëherë kur realizohet procedura e shkurtuar.

Edhe pse nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procedurën për marrëveshje për pranim të fajit, me qëllim që të mbrohen interesat e të dëmtuarit, për të cilin me prioritet është vendimi që ka të bëjë me kërkesën pronësore-juridike, është paraparë si obligim i prokurorit publik, që së bashku me të gjitha dëshmitë e siguruar të parashtrijë detyrimisht edhe deklaratë me shkrim të nënshkruar nga i dëmtuari. Në këtë mënyrë realizohet pjesëmarrje e tërthortë e të dëmtuarit nëpërmjet prokurorit publik. Megjithatë, deklarata e dhënë nuk është garanci se kërkesa pronësore-juridike do të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit. Siç u theksua edhe më herët, kjo varet nga pëlqimi i të akuzuarit se kërkesa pronësore-juridike a do të jetë subjekt i marrëveshjes për pranim të fajit. Megjithatë mbetet mundësia që të drejtat e tij i dëmtuari t'i realizojë në procedurë kontestimore.

#### **4. STATUSI I DEKLARATËS PËR PRANIM TË FAJIT GJEGJËSISHT PRANIMI I KRIMIT SIPAS LPP-SË**

Ekzistojnë dallime në mundësitë për dhënie të deklaratës për pranim të fajit gjegjësisht të pranimit të krimit në stadi të ndryshme të procedurës, pas përfundimit të procedurës hetimore.

Deklarata për pranim të fajit është parakusht për realizim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit në mes të palëve në fazën e kontrollit të akuzës, gjë që nuk ndodh në procedurën hetimore.

Në procedurën hetimore, drejtpërsëdrejti zbatohen dispozitat për sjellje të aktgjykimit në bazë të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit në mes të palëve pa pranim paraprak të krimit nga i akuzuari, poqë se nga cilado palë ka ardhur iniciativa për fillim të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit. Edhe përkundër faktit se nuk bëhet pranim i fajit në mënyrë të prerë për veprat për të cilat prokuroria ka sjellë vendim për fillim të procedurës hetimore, kjo



## 26

bëhet në mënyrë implicite, me anë të iniciativës për fillim të procedurës për marrëveshje për pranimit të fajit, gjegjësisht me fillim të bisedimeve për marrëveshje për pranimit të fajit me propozim të prokurorisë.

### 4.1. Vlerësimi i akuzës

Në fazën e vlerësimit të akuzës deklarata për pranimit të fajit është parakusht për realizim të procedurës për marrëveshje për pranimit të fajit ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit bashkë me mbrojtësin e tij.

Për dallim nga procedura hetimore ku iniciativa për marrëveshje për pranimit të fajit mund të vijë nga të dy palët, në stadin e akuzës iniciativa vjen nga mbrojtja me shprehje të gatishmërisë për të bërë pranimit të fajit për veprat e përfshira në akuzë.

Gatishmërinë për të bërë pranimit të veprave i dyshuari mund ta bëjë në dy mënyra:

- me parashtrim të **deklaratës me shkrim** ku thekson gatishmërinë për dhënie të deklaratës për pranimit të fajit sa i përket të gjitha apo disa veprave penale të përfshira në aktakuzë – me ç’rast gjykatësi, në këshillin për vlerësim të aktakuzës, është i obliguar të caktojë seancë për vlerësim të pranimit të krimin, apo
- **në seancën për vlerësim të akuzës** të japë deklaratë **me gojë** se ndjehet fajtor për të gjitha apo për disa vepra penale të përfshira në aktakuzë – me ç’rast procedura vazhdon sipas dispozitave për ecurinë e seancës kur ka deklaratë për pranimit të fajit.

Parakusht për fillim të procedurës për marrëveshje për pranimit të fajit është vendimi i gjykatësit kompetent, gjegjësisht i këshillit për vlerësim të akuzës për atë se a është deklarata e pranueshme apo jo.

Nëse gjykatësi apo këshilli për vlerësim të aktakuzës **nuk e pranon deklaratën** për pranimit të fajit, këtë duhet ta konstatojë me procesverbal, i njofton palët e pranishme me vendimin e tij dhe vazhdon me realizim të seancës për vlerësim të aktakuzës. Deklarata e parashtruar për pranimit të fajit, gjegjësisht procesverbali në të cilin është përfshirë ajo, nuk mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurën e mëtutjeshme penale, kështu që ato mbyllen në mbështjellëse të veçantë dhe ndahen nga aktet e lëndës.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 27

Gjykatësi, gjegjësisht këshilli do të sjellë vendim se **deklarata e dhënë është e pranueshme** pasi të kontrollojë:

- vallë ajo është e dhënë në mënyrë vullnetare, me vetëdije dhe pasi të jenë kuptuar pasojat e saj, duke përfshirë edhe pasojat e ndërlidhura me kërkesën pronësore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, dhe
- vallë ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për fajin e të dyshuarit.


Për dallim nga marrëveshja për pranim të fajit gjatë procedurës hetimore, ku nuk ekziston **kufizim kohor për arritje të marrëveshjes për pranim të fajit**, në stadin e akuzimit, palët kanë afat kohor prej 15 ditësh që të merren vesh për sanksion penal të pranueshëm për të gjithë dhe të parashtrojnë propozim-marrëveshje për pranim të fajit deri te gjykatësi, gjegjësisht këshilli kompetent për vlerësim të akuzës.

Nëse në këtë afat kohor palët **nuk parashtrojnë propozim-marrëveshje për pranim të fajit**, vazhdohet me seancën për vlerësim të akuzës së parashtruar.

Nëse **propozim- marrëveshja për pranim të fajit është parashtruar** pason vlerësimi i saj i cili mund të jetë:

- pozitiv : propozim- marrëveshja për pranim të fajit të pranohet, me ç'rast gjykatësi apo këshilli për vlerësim të aktakuzës sjell aktgjykim sipas dispozitave për sjellje të aktgjykimit në bazë të propozim-marrëveshjes, apo
- negativ: propozim- marrëveshja për pranim të fajit të mos pranohet, me ç'rast gjykatësi apo këshilli për vlerësim të aktakuzës sjell aktvendim për mospranim të propozim- marrëveshjes dhe vendos sa i përket aktakuzës. Propozim- marrëveshja e cila nuk është e pranuar nuk mund të shfrytëzohet si dëshmi në procedurën e mëtutjeshme penale.

## AKTGJYKIMI NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR PRANIM TË FAJIT NË FAZËN E VLERËSIMIT TË AKTAKUZËS



### 4.2. Pranim i krimit i dhënë në shqyrtimin kryesor

Sipas dispozitave të LPP-së ekziston mundësia për pranim të krimit në fazën e shqyrtimit kryesor pas fjalimeve hyrëse të palëve, mirëpo para fillimit të procedurës dëshmuese.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 29

Pas udhëzimit për të drejtat që i ka i akuzuari (të drejtën për të heshtur apo për të dhënë deklaratë, për ta ndjekur me kujdes ecurinë e shqyrtimit kryesor, për mundësinë e prezantimit të dëshmisë në mbrojtje të tij, për të drejtën t'u parashtrijë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe për të drejtën të japë vërejtje sa i përket deklaratave të tyre), kryetari i këshillit do ta ftojë të akuzuarin që të deklarohet se a ndihet fajtor për të gjitha apo për disa vepra penale të përfshira në akuzë.

I akuzuari mund ta pranojë fajin në mënyrë vullnetare sa i përket njërës apo më shumë veprave penale nga akuzat.

Pranimi i krimit nuk është i kufizuar as me natyrën e as me peshën e veprës penale për të cilën zhvillohet procedura.


Pas marrjes së pranimit të krimit me vullnet të lirë, gjykatësi individual ose kryetari i këshillit është i obliguar t'i shqyrtojë këto rrethana:

- vallë pranimi i krimit është bërë me vullnet të lirë;
- vallë i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike të pranimit të fajit;
- vallë i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat që kanë të bëjnë me kërkesën pronësore-juridike; dhe
- vallë i akuzuari është i vetëdijshëm për shpenzimet e procedurës penale.

Nëse pranimi i krimit vlerësohet si i **papranueshëm**, i dhënë në gjendje hutie, si rezultat i moskuptimit të mjaftueshëm të pasojave që ndërlidhen me to dhe të ngjashme, gjyqi vazhdon me realizimin e shqyrtimit kryesor (d.m.th. fillon procedura dëshmuese), me ç'rast procesverbali për pranimin e krimit ndahet nga aktet dhe konsiderohet sikur të mos ishte dhënë asnjëherë dhe, si i tillë, nuk do të mundet të shfrytëzohet në pjesën e mëtutjeshme të procedurës.

Nëse pranimi i krimit **pranohet**, gjyqi e fillon procedurën dëshmuese në kuadër të së cilës prezantohen vetëm dëshmitë që kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin penal. Risitë që lidhen me pranimin e krimit mundësojnë një **racionalizim të veprimeve që e përbëjnë shqyrtimin kryesor**, me ç'rast pesha e rrethanave që i përkasin fajit, përgjegjësia penale e të akuzuarit dhe gjendja faktike barten në rrethana që kanë të bëjnë me llojin dhe lartësinë e sanksionit penal sipas dispozitave për vlerësimin e dënimit të KP-së.

Në rast se deklarata për pranimit të krimit është pranuar, edhe atë pas prezantimit të dëshmimeve që janë të rëndësishme për sanksionin penal, gjyqi sjell **aktgjykim** që i përmban të gjitha elementet e aktgjykimit ndëshkues. Duhet theksuar se kundër aktgjykimit, apo pjesës së aktgjykimit që është sjellë si rezultat i pranimit të krimit të dhënë pas fillimit të shqyrtimit kryesor, i akuzuari nuk mund të parashtrojë ankesë për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht apo mosvërtetimit të saj në tërësi.



## 5. IMPLIKACIONET NGA MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT MBI DISPOZITA TË TJERA TË LPP-SË

Marrëveshja për pranim të fajit dhe deklarata për pranim të fajit kanë ndikimin e tyre edhe mbi dispozita të tjera të LPP-së, gjegjësisht mbi institucione të tjera procedurale, si p.sh.:

- **Ndarja e procedurës** – në rast se pranohet faji për një pjesë të veprave penale të përfshira në akuzë, gjegjësisht faji të pranohet nga disa të bashkakuzuar, gjyqi mund të vendosë, deri në përfundim të shqyrtimit kryesor, që procedura për disa vepra penale apo ndaj disa të akuzuarve të ndahet dhe të përfundohet në mënyrë të veçantë apo t'i dorëzohet ndonjë gjyqi tjetër kompetent.
- **Mbrojtja e detyrueshme** – gjatë procedurës për negociata dhe asaj për të bërë marrëveshje për pranim të fajit me prokurorin, i akuzuari duhet, patjetër, të ketë mbrojtës.
- **Bazat për të përcaktuar paraburgim** – nëse i akuzuari ka dhënë deklaratë me të cilën e ka pranuar fajin nuk do t'i përcaktohet masë paraburgimi, edhe pse ekziston dyshim i arsyeshëm se ai ka kryer veprë penale, për shkak të ekzistimit të një frike të arsyeshme se do t'i fshehë, falsifikojë apo do t'i shkatërrojë gjurmët e veprës penale ose nëse rrethana të veçanta kuptohet se ai do ta pengonte procedurën penale duke ndikuar mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkëpjesëmarrësit si dhe mbi fshehësit.
- **Ndërprerja e paraburgimit** – paraburgimi do të ndërpritet me aktvendim dhe i akuzuari do të lëshohet në liri nëse paraburgimi është përcaktuar për shkak të frikës së arsyeshme se do t'i fshehë, do t'i falsifikojë apo do t'i shkatërrojë gjurmët e veprës penale ose, në rrethana të veçanta, vihet në dijeni se ai do ta pengojë procedurën penale me ndikim mbi dëshmitarët, ekspertët, bashkëpjesëmarrësit apo fshehësit, ndërsa i akuzuari ka dhënë deklaratë për pranim të fajit.
- **Udhëzim për të drejtat e të akuzuarit** – para çdo marrjeje në pyetje, i akuzuari detyrimisht do të informohet dhe do të udhëzohet, në mes tjerash, edhe për të drejtën për të bërë marrëveshje për pranim të fajit me prokurorin publik.
- **Sjellja e aktgjykimit** – Marrëveshja për pranim të fajit, gjegjësisht pranimi i krimit mundëson rigjykim në stadi (faza) të ndryshme të procedurës duke filluar qysh nga hetimi.

<b>SJELLJA E AKTGJYKIMIT</b>			
<b>STADI I PROCEDURËS</b>	<b>STATUSI I PRANIMIT TË KRIMIT</b>	<b>EFEKTI PËRFUNDIMTAR</b>	<b>SUBJEKTI KOMPETENT PËR SJELLJE TË AKTGJYKIMIT</b>
procedura hetimore	Nuk është parakusht	Aktgjykim në bazë të marrëveshjes për pranim të fajit në mes të palëve	Gjykatësi i procedurës paraprake
vlerësimi i aktakuzës	Është parakusht	Aktgjykim në bazë të marrëveshjes për pranim të fajit në mes të palëve	Gjykatësi gjegjësisht këshilli për vlerësim të aktakuzës
fillimi i shqyrtimit kryesor	Është parakusht	Aktgjykim pas prezantimit të dëshmive që kanë të bëjnë me sanksionin penal	Gjykatësi individual gjegjësisht këshilli i cili udhëheq me shqyrtimin kryesor

## 6. SFIDAT DHE RREZIQET

### Ç'pritet nga marrëveshja për pranim të fajit dhe deklarata për pranim të krimit?

- Shkarkim të gjyqeve nga një pjesë e lëndëve ku palët do të arrijnë të merren vesh?
- Për shkak se nuk ekziston kufizim sa i përket natyrës dhe peshës së veprave penale për të cilat është e lejuar marrëveshja për pranim të fajit, palët mund ta zbatojnë marrëveshjen për pranim të fajit çdoherë kur të vlerësojnë se ajo është në dobi të të dyja palëve;
- Gjykatësit do të kenë më shumë kohë t'u kushtojnë lëndëve komplekse penale me gjendje faktike të komplikuar, numër të madh dëshmish dhe autorësh e të ngjashme;
- Zvogëlim të shpenzimeve të procedurave gjyqësore për shkak se zvogëlohet në masë të konsiderueshme kohëzgjatja prej fillimit të procedurës penale deri në sjelljen e aktgjyimit;
- Rol proaktiv të palëve;
- Përfundim të procedurës në fazë më të hershme me sjellje të vendimit meritore;

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 33

- Rezultat të qartë përfundimtar i cili mbështetet mbi konsultime, biseda dhe kompromise në mes të palëve dhe mbrojtësit të cilat rezultojnë me nënshkrim të propozim- marrëveshjes për pranim të fajit;
- Aftësi të mbrojtësit për të vlerësuar se sa është e volitshme për klientin e tij që të shprehë gatishmëri për pranim të fajit, gjegjësisht të bëjë pranim të krimit para gjyqit, përkundrajt rezultatit përfundimtar të procedurës të cilën e përbëjnë veprimet e zakonshme procedurale nëpër stadet e saja të ndryshme.

**Cilat janë rreziqet e mundshme respektivisht vështirësitë praktike?**

- Korniza të gjera të sanksioneve të parapara në KP-së;
- Politika ndëshkuese e cila silltet rreth minimumit ligjor të paraparë të sanksioneve;
- Nevoja për ndryshime në KP sa i përket zbutjes së dënimeve në rast të procedurës për marrëveshje për pranim të fajit, gjegjësisht dhënies së deklaratës për pranim të krimit;
- Vështirësi për palët që të vlerësojnë vallë u konvenon më shumë marrëveshja për pranim të fajit apo procedura e rregullt penale;
- Praktika e pabarabartë gjyqësore në shqiptimin e sanksioneve penale për vepra të njëjta apo të ngjashme penale;
- Mosekzistimi i sanksionit të llogaritur mesatar për vepra të ndryshme kriminale sipas praktikës gjyqësore gjatë disa viteve të kaluara etj.





## PJESA 2

### PRAKTIKA KOMPARATIVE PËR MARRËVESHJEN PËR PRANIM TË FAJIT

#### 1. HYRJE

“Marrëveshja për pranimin e fajit” tradicionalisht është parë si pjesë e sistemit të së drejtës penale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve tjera me ligj zakonor.

Shpesh përdoret si term i përgjithshëm për të përshkruar negociim mes prokurorisë dhe mbrojtjes për t’u deklaruar i fajshëm në kushte të negociuara. Në kuptim teknik, megjithatë, kjo ndodhë vetëm atëherë kur i pandehuri ndërron deklarinimin prej nga i pafajshëm në të fajshëm në këmbim të dënimit të zvogëluar.

Një raport i fundit i OSBE-së e definoi atë si “një proces marrëveshjeje mes të pandehurit dhe prokurorit në të cilin i pandehuri pranon se ka kryer krim dhe prokurori pajtohet për disa lëshime në këmbim. Marrëveshja pastaj dorëzohet në gjyq me qëllim që të shmanget seanca gjyqësore.”<sup>17</sup>

Teknikisht, një marrëveshje për akuzën ndodh kur prokuroria pajtohet të hedhë poshtë një akuzë më të rëndë në këmbim për deklarim të fajësisë për kundërvajtje më të lehtë ose i pandehuri deklarohet fajtor për së paku një akuzë në këmbim që prokurori të hedhë poshtë së paku një akuzë. Marrëveshja për faktin është kur prokuroria prezanton një version më të favorshëm të fakteve të supozuara lidhur me veprën penale në këmbim për deklarim fajtor. Marrëveshja për dënimin zakonisht referon rastet në të cilat gjykatësi ka dhënë indikacion për dënim të mundshëm nëse i pandehuri deklarohet fajtor.

Procesi në të cilin i pandehuri bashkëpunon me prokurorinë ose me gjykatën nganjëherë referohet si “drejtësi e negociuar” sepse rezultati përfundimtar është arritur në bazë të një lloj negociate.

<sup>17</sup> Misioni i OSBE-së në Bosnjë e Hercegovinë, “Marrëveshjet e Deklarimit në Bosnjë e Hercegovinë: Praktikrat para Gjykatës dhe përputhja e tyre me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” Botimi i 2-të maj 2006, faqe 7 (Raporti i OSBE-së për marrëveshjet për pajtimin e fajit).

## 36

Në sistemet e ligjit zakonor kundërshtues i pandehuri duhet të hyjë në një deklaram formal të fajësisë ose pafajësisë për akuzat para gjyqit.

Ky koncept është i huaj për sistemet e së drejtës civile inkuizitore në të cilat kërkohet nga gjykatësi të bëjë përcaktimin ligjor të fajësisë pas shqyrtimit të, të gjitha dëshmive pavarësisht nëse i pandehuri pranon fajësinë. Koncepti ku i pandehuri formalisht të deklarohejt fajtor ose jo fajtor është futur në disa sisteme të së drejtës civile që përdorin procedura gjyqësore kundërshtuese, siç është Bosnja e Hercegovina, por jo edhe në vende tjera si Italia.

Sistemet e ligjit zakonor kundërshtues paraqesin një dëgjim kontestues mes prokurorisë dhe mbrojtjes, që të dyja duke prezantuar raste të ndryshme. Shumica dërmuese e rasteve të sjella para gjyqit në sistemet e ligjit zakonor nuk kontestohen me atë që i pandehuri deklarohejt fajtor. Ekzistojnë dallime të prera mes sistemeve të ligjit zakonor në mënyrën e deklaramit të fajësisë dhe arrihet (dënimi më i lartë).

Në Shtetet e Bashkuara ku marrëveshja për pranimin e fajit është e gjithë-pranishme, vlerësohet se është përdorë në gati 95% të rasteve të ndjekura penalisht. Atje palët mund të merren vesh edhe për akuzën edhe për dënimin dhe dënimi i arritur mund të sugjerohet në gjyq. Në Angli dhe në Uells, për dallim, negociatat bëhen për akuzën dhe për faktet që mbështesin akuzën (akuzat) por jo edhe për dënimin dhe gjykata mund të mbajë një dëgjim për faktet e kontestuar. Sistemi kundërshtues italian përmban ujdj për dënimin, por jo edhe marrëveshje për akuzën. Sistemi kundërshtues i Bosnjës mundëson marrëveshje për dënimin por në praktikë palët, gjithashtu, negociojnë edhe për akuzat dhe faktet. TNKJ (Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ish Jugosllavi) përmban marrëveshje edhe për akuzë edhe për dënimin. Në Itali dhe në Bosnjë e Hercegovinë gjyqi, nëse pranon marrëveshjen për pranimin e fajit, lidhet për dënimin nga marrëveshja. Në TNKJ dhe në Shtetet e Bashkuara gjykata nuk obligohet për këtë. Statuti dhe Rregullorja e Gjykatës Ndërkombëtare për Krime heshtin në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajit.

Sistemet e ligjit zakonor kundërshtues mbështeten në negociatat për deklaram me qëllim të funksionimit efikas të sistemeve të tyre të drejtësisë penale. Reformat italiane të vitit 1988, duke shfuqizuar gjykatësin hetues dhe duke futur në fuqi seancat gjyqësore kundërshtuese, gjithashtu, zgjodhën

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 37

marrëveshjen për pranimin e fajit meqë e njëjta shihet si pjesë e domosdoshme e sistemit kundërshtues.

Marrëveshja për pranimin e fajit mund të jetë kontroverse dhe të tërheqë edhe mbështetje të fortë si edhe kritikë të ashpër.

Përfitimet e drejtësisë së negociuar të cilat çojnë në dënime më të ulëta përshkruhen në aspektin e uljes së harxhimeve të drejtësisë publike dhe në asistimin e të pandehurit dhe të dëshmitarëve. Dëshmitarët dhe viktimat kursehen nga dhënia e dëshmisë në gjykatë, rastet gjyqësore janë më të shkurta dhe shumë më shpejtë zgjidhen, po edhe zvogëlohet numri i punëve që ndërlihem me vetë rastin. Negociatat për deklarim po ashtu ndihmojnë në mundësimin e “mbylljes” ose rivendosjes së drejtësisë, për shembull, në rastet e krimeve të luftës ku mund të bihet në ujdë për dhënie të informacionit siç është lokacioni i varrezave dhe informacioni lidhur me personat e humbur. Politika publike për zbulimin e krimit dhe për sjelljen e të pandehurve para drejtësisë është përparuar gjithashtu, meqë të pandehurit mund të pajtohen të japin informacion ose inteligjencë ose të dëshmojnë në raste të tjera për këmbim të një dënimi të zvogëluar. Ithtarët tjerë vërejnë se kjo i lejon të pandehurit të shprehë pendimin në lidhje me krimin dhe ndikimin që ka pasur në të prekurit nga krimi.

Kritikët pohojnë se kjo mundëson një shtytje për t'u deklaruar i fajshëm gjë që shkakton që njerëzit e pafajshëm të deklarohen fajtor dhe, kjo uzurpon autoritetin gjyqësor për t'i dhënë më shumë kompetencë prokurorit, kështu që prokurorët mbingarkohen dhe me këtë detyrojnë të pandehurit të negociojnë për deklarim të fajësisë edhe për kundërvajtje më të lehta gjithnjë me shpresë të marrjes së dënimit më të vogël dhe se të pandehurit mund të japin informacion të rrejshëm kundër të tjerëve për këmbim të marrëveshjes për pranimin e fajit.

Përkundër këtyre kritikave, marrëveshja për pranimin e fajit, në një formë apo tjetër, po e rritë popullaritetin e vet në sistemet e ligjit zakonor kundërshtues dhe ato të së drejtës civile. Në kohë të fundit, për shembull, Franca, Rusia, Argjentina, Afrika e Jugut dhe India, mes shteteve tjera, përhapin këtë marrëveshje edhe në mënyrë formale.

Si shembull të një sistemi që nuk është shqyrtuar më poshtë, përvoja e para ca kohe e Tajvanit tregon se si një sistem i përparshëm, i pastër i të drejtës civile, fut në përdorim disa procedura kundërshtuese, përfshirë këtu edhe marrëveshjen për pranimin e fajit. Reformat e vitit 2004 dhanë marrëveshje për pranimin fajit të kufizuar nën titullin “procedurat për negociim.”<sup>18</sup> Sistemi i përparshëm shprehte karakteristika inkuizitore me një hetim të kontrolluar nga prokurori që çonte deri te një aktakuzë dhe shqyrtim të dosjes së rastit nga ana e gjyqit. Më parë seanca gjyqësore ishte një marrje në pyetje nga ana e gjykatësit me pak pjesëmarrje të prokurorisë dhe mbrojtjes. Sistemi i ri është një kontest i udhëhequr nga palët kundërshtuese mes prokurorisë dhe mbrojtjes para gjykatësit neutral edhe pse gjykatësi prapë pranon dosjen para-gjyqësore. Negociatat për kundërvajtjet jo të rënda mund të fillojnë pas aktakuzës dhe të përqendrohen në kohëzgjatjen e dënimit edhe pse i pandehuri mund të pajtohet të kërkon falje ose të paguan për kompensim të viktimës ose ndonjë shumë parash për ndonjë organizatë. Gjykatësit nuk mund të marrin pjesë në negociata por duhet patjetër të konfirmojnë se të pandehurit kanë kuptuar se kanë hequr dorë nga disa të drejta të caktuara. Gjykatësi mund të pranojë marrëveshjen dhe të dënojë të pandehurin në kushtet e caktuar me marrëveshje, ose mund ta refuzojë atë dhe të kërkojë seancë gjyqësore. Gjykatësi patjetër duhet të refuzojë marrëveshjen në rrethana të saktësuara<sup>19</sup>.

## 2. ANGLIA DHE UELLSI (MBRETËRIA E BASHKUAR)

### 2.1. Hyrje

Sistemi i të drejtës penale në Angli dhe në Uells për kohë të gjatë kanë shfrytëzuar principin e ligjit zakonor kundërshtues për deklarim formal të pafajësisë ose të fajësisë për një akuzë të sjellë para gjykatës. Nga i pandehuri kërkohet që të futet në deklarim formal të pafajësisë ose fajësisë për akuzën e sjellë para gjykatës.

Ligji dhe praktika në lidhje me dënimin dhe deklarimin e fajësisë përfshihet në një përzierje të rastit të së drejtës zakonore, legjislativës, udhëzimeve të praktikës gjyqësore, udhëzuesve ligjor, dhe kodeve të avokatëve. Ajo është objekt i amendamenteve të shpeshta nga ana e legjislatorit dhe interpretimit

<sup>18</sup> Nenet 455-2 deri -11nga Kodi i Procedurës Penale të Tajvanit

<sup>19</sup> Shih, Margaret K. Lewis “Sistemi i Ri Kundërshtues i Tajvanit dhe Sfida e Neglizhuar për Reforma Drejtuar Efikasiteti” 49 Zhurnali i Virgjinias për Ligjin Ndërkombëtar 651 (2008-2009).

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 39

nga ana e gjykatave më të larta. Doktrina e *stare decisis* ose e precedentit, një nga karakteristikat themelore dalluese të sistemit të së drejtës zakonore – që detyron në gjykatat më të ulëta me vendimet e gjykatës më të lartë në hierarkinë e gjykatave – e ka Gjykata e Apelit që në vazhdimësi lëshon vendime të freskëta në lidhje me precedentin juridik obligues.

Policia është fillimisht përgjegjëse për hetimin e krimit. Zyra e Prokurorisë (ZP) i drejtuar nga Drejtori i Prokurorisë Publike tani është përgjegjës për udhëheqjen e akuzave për shumicën e krimeve të sjella para gjykatës.

Policia tani ka rol shumë më të kufizuar në procesin e akuzës formale, në përgjithësi e kufizuar në kundërvajtje të veçanta siç janë shkeljet e vogla në komunikacion, kundërvajtjet në rrugë dhe kundërvajtjet e prishjes së rendit publik, si dhe çdo kundërvajtje që i takon Gjykatës për kundërvajtje të dënueshme deri në tre muaj burgim, e cila sigurisht që çon në numër të konsiderueshëm të rasteve. Në të gjitha rastet tjera, Prokurorët përcaktojnë akuzën që sillet para gjyqit dhe informojnë policinë për mënyrën e akuzimit.

ZP ka një rol statusor formal në procesin e negociatave për deklarim të fajësisë. Ky proces nuk referohet si “marrëveshje për pranimit faji” në kuptim të asaj se si kuptohet, si për shembull, në Shtetet e Bashkuara, në tribunalet ndërkombëtare dhe në Bosnjë e Hercegovinë. Megjithatë, efekti praktik në kuptim të negociimit të marrëveshjes për pranimit faji është mjaft i ngjashëm.

Historikisht, ata të cilët deklarohen fajtorë në përgjithësi kanë marrë dënime më të ulëta në krahasim me dënimet e aplikueshme nëse vërtetohet fajësia pas mbajtjes së seancës së dëgjimit gjyqësor. Praktika e përgjithshme tregon se pranimit i fajit në kohë ka bërë që dënimi të ulet për gati një të tretën, në krahasim me dënimin me të cilin, për ndryshe, do të ngarkohej.<sup>20</sup>

Akti për Drejtësi Penale i vitit 2003 parasheh se i akuzuari *mund* të marrë zvogëlim statusor të dënimin në rast të deklarimit të fajësisë dhe se gjykata duhet patjetër të marrë parasysh kur i pandehuri shfaq qëllimin për t'u deklaruar fajtor si dhe rrethanat në të cilat një shenjë e tillë është dhënë.<sup>21</sup> Kjo nuk siguron kurrfarë “të drejte” statusore apo “të pasurit të drejtë për” përvogëlim dënimi. Akti për Drejtësi Penale, po ashtu, nuk e rregullon ‘tarifën’

<sup>20</sup> Në R. *kundër Buffrey* 14 Cr. App. R (S) 511: Gjykata e Apelit vendosi kur nuk kishte asnjë rregull absolute për atë se si duhej të ishte zvogëlimi i dënimin, meqë si udhëzim i përgjithshëm për zvogëlim të përshtatshëm ishte një e treta

<sup>21</sup> Seksioni 144, Akti për Drejtësi Penale 2003

## 40

apo zvogëlimin e dënimit, duke cekur vetëm se “asgjë nuk ndalon” gjykatën për të dhënë një dënim që nuk është më pak se 80 për qind nga kundërvajtjet e veçuara të cilat bartin kushte minimale statusore për burgosje.

Gjatë dhënies së dënimit gjykata “duhet të ketë parasysh çfarëdo direktiva të cilat janë relevante për rastin e të pandehurit”<sup>22</sup>. Këshilli për Dhënie Dënimi i formuar sipas legjislaturës ka botuar një numër të madh të direktivave në lidhje me dhënien e dënimit. Funkzioni i tij – të promovojë konsistencë në dënim – është për të vendosur direktiva për parimet e dhënies së dënimeve dhe për kundërvajtjet e veçanta. Direktiva definitive e këshillit për dënime “Zvogëlimi i dënimit për pranim të fajësisë” (2007) veçon një shkallë rrëshqitëse të dënimeve. Këto përfshijnë prej zvogëlimeve të rekomanduara për një të tretën për deklarata të dhëna, me mundësinë më të parë të mundur, deri te një e dhjeta për deklarata të dhëna në “pragun e gjykatës”. Direktiva parasheh rrethana të kufizuara, ndryshe nga koha kur bëhet pranimi, kur zvogëlimi mund të refuzohet ose të ulet, siç është rasti në një rast të pakalueshëm të ndjekjes të jashtëzakonshme penale.

Direktiva thekson si princip se “ulja e dënimit është e përshtatshme për shkak se pranimi i fajësisë shmangë nevojën për seancë gjyqësore (kështu mundësohet që rastet e tjera të zgjidhen në mënyrë më ekspeditive), ngushton mospërputhjen mes akuzës dhe dënimit, kursen harxhime të konsiderueshme dhe, në rast të pranimit të hershëm, kursen viktimat dhe dëshmitarët nga brenga se duhet të dëshmojnë. Principi i uljes së dënimit buron nga nevoja për administrim efikas të drejtësisë dhe jo si një aspekt i lehtësimit”.

Në përgjithësi, mbi 90% e të pandehurve në Angli dhe në Uells deklarohen fajtorë. Shumica e kundërvajtjeve – rreth 98% – ndiqen penalisht nga Gjykata për kundërvajtje pa juri. Madje edhe në Gjykatat të shkallës së parë (për seanca gjyqësore për aktakuzë për kërcënime më serioze) në Angli dhe në Uells mbi 60% të rasteve rezultojnë me deklarim të fajësisë, ndërsa vetëm rreth 14-15% çojnë në shqiptim dënimi nga ana e jurisë. Gjykatat për Kundërvajtje i dërgojnë rastet me kundërvajtje më të rënda në Gjykatat themelore për shqiptim të dënimit ose për seancë gjyqësore. Për shkak se në Gjykatat themelore procedura që përdoret është më e afërt me marrëveshjen për pranim të fajësisë, ky doracak përshkruan procedurat e përdorura në këto gjykata.

<sup>22</sup> Seksioni 172, Akti për Drejtësi Penale 2003

Kur kalohet rasti tek Gjykata themelore i pandehuri deklaron fajësinë, pikë së pari, në tri faza.

E para është **deklarimi fajtor për të gjitha ose për disa nga akuzat** sipas rastit të ndjekjes penale të shtruar në dokumentacionin e gjykatës. E dyta është deklarimi fajtor në bazë të **deklarimit të negociuar mes palëve** ose në bazë të deklarimit të parashtruar nga ana e mbrojtjes, por i pakontestuar nga ana e prokurorisë. Kjo është e njohur si “**deklarim i bazuar në marrëveshje**”. E treta lidhet në veçanti me **raste të rënda ose komplekse të mashtrimit** ku pranimi i fajësisë, i marrë vesh mes palëve dhe i përcjellë me paraqitje të përbashkët, i përket dënimit.

Në negociimin e deklarimit të fajësisë me mbrojtjen, prokurorët i përmbahen direktivave të sjellura nga Ministria e Drejtësisë nga Prokurori Publik,<sup>23</sup> Drejtori i Prokurorisë Publike, Kodit të Prokurorëve, si dhe Udhëzimit të Praktikave të Bashkuara Kriminale nga Rregullat e Procedurës Penale.

Principet e politikës publike në lidhje me deklaramet e fajësisë në gjykata në mënyrë të përgjithësuar janë të caktuara në direktivat e Prokurorit Publik (të ndryshueshme) udhëzime në lidhje me kundërvajtjet e mashtrimeve të rënda (shih më poshtë). Direktivat cekin se qëllimi i diskutimit për pranim është “të ngushtohen çështjet e përfshira në rast me synim që të arrihet një zgjidhje e drejtë në kohë sa më të shkurtër të mundshme, përfshirë edhe mundësinë e arritjes së marrëveshjes për pranim të fajësisë dhe përgatitjes së paraqitjes së përbashkët në lidhje me dënimin.”

Dobitë potenciale janë të përshkruara si: zgjidhje e shpejtë e rastit që mund të zvogëlojë ankthin dhe pasigurinë të viktimat dhe dëshmitarët dhe të mundësojë një sqarim më të hershëm për personat e akuzuar të cilët pranojnë fajin e tyre dhe zvogëlimin e çfarëdo çështjeve në kontest ashtu që rasti të mund të menaxhohet me më shumë efikasitet në rast se ai përcillet në seancë gjyqësore.

## 2.2. Pranimi i fajit për të gjitha ose disa nga akuzat

I pandehuri mund të deklarohet fajtor për të gjitha akuzat në bazë të fakteve të pretenduara nga prokuroria. Po ashtu, si alternativë, i pandehuri mund të deklarohet fajtor për disa nga akuzat. Gjykatësi duhet të gjykojë nëse deklarimi

<sup>23</sup> Udhëzime të Ministrit të drejtësisë për pranim faji dhe roli i prokurorit në përcaktimin e dënimit.



## 42

është me vend në bazë të fakteve të pretenduara. Gjykatësi mund të vazhdojë dhe të ndajë dënimin nëse është i kënaqur me faktin se deklarimi është i bazuar si duhet.<sup>24</sup>

Palët mund të pajtohen që i akuzuari të deklarohet fajtor për një pjesë të aktakuzës dhe prokurori të mos ofrojë dëshmi për të mbështetur pjesët tjera ose pretendimet e aktakuzës. Pas pranimit të deklarimit për të lehtësuar akuzat prokurori mund të ftojë gjykatësin për të miratuar propozimin. Gjykatësi mund ta refuzojë këtë.

Si alternativë, prokurori mund të vazhdojë pa kërkuar miratimin e gjykatësit. Gjykatësi mund të shprehë mospajtim dhe të ftojë prokurorin të rishikojë rastin. Gjykatësi mund të pezullojë procedurën gjyqësore nëse mendon se rruga e propozuar nga ana e prokurorit “mund të çojë deri në padrejtësi të rëndë”. Pastaj prokurori duhet, patjetër, ta diskutojë këtë me prokurorët e lartë të caktuar dhe në rrethana ekstreme gjykatësi mund të refuzojë të vazhdojë deri sa autoriteti për ndjekje konsultohet me Prokurorin Publik.

Para se të futet në deklarim të fajësisë i pandehuri mund të kërkojë **para kohe një të dhënë për dënimin** (shih më poshtë).

### 2.3. Bazat e dakorduara të deklarimit të fajësisë

Prokuroria dhe i pandehuri mund të pajtohen për bazat faktike në të cilat i pandehuri do të deklarojë fajësinë, e njohur si “baza të dakorduara të deklarimit të fajësisë”. Ky është fundi i procesit të negociatave në mes të prokurorisë dhe të pandehurit. Gjyqi duhet patjetër të miratojë deklaratën e dorëzuar në këtë bazë. Gjyqi duhet të mendojë nëse pranimi i saj është i drejtë dhe në interes të së drejtës.

Principet janë ligj zakonor i pastër dhe janë të vendosur në vitin 2004 në rastin e Gjykatës së Apelit për *R kundër Underwood*<sup>25</sup>:

- Prokuroria mund të pranojë dhe të dakordohet me shpjegimin e të pandehurit për faktet e diskutueshme ose t’i refuzojë ato në tërësi. Nëse pranohen, prokuroria duhet të sigurojë se ato në fakt janë të sakta;

<sup>24</sup> Udhëzimi i praktikave të bashkuara kriminale, paragrafi IV.45 ‘Udhëzime të tjera që aplikohen në Gjykatën e Lartë.

<sup>25</sup> *R. kundër Underwood* [2004] EWCA Crim 2256 [2005] 1 Crim. App. R. (S) 90.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 43

- Detyrim primar i Prokurorisë është ndaj gjyqit, prandaj ajo nuk duhet të pajtohet për marrëveshje me elemente kontestuese në pjesën e fakteve dhe të drejtës materiale;
- Marrëveshja duhet detyrimisht të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga prokuroria dhe si etillë ti dorëzohet gjyqit;
- Marrëveshja nuk duhet të përmbajë elemente kontestuese; dhe
- Marrëveshja lidhur me pranimin e fajit mes palëve nuk duhet të ketë elemente kontestuese.

Prokurori patjetër të sigurojë se avokati mbrojtës është në dijeni për bazën mbi të cilën është pranuar deklarimi dhe mënyrën në të cilën prokuroria do të prezantojë rastin e vet në gjyq.<sup>26</sup> Direktiva e Prokurorit Publik për pranimin e deklarimit të fajësisë thotë se:

“Baza e deklarimit për fajësi nuk guxon të miratohet në bazë të një sërë faktesh të pavërteta dhe mashtruese dhe patjetër të merren në konsideratë të duhur interesat e viktimës. Një bazë jo logjike ose e pambështetur e deklarimit të fajësisë, pashmangshëm do të rezultojë me imponim të një dënimi të pavend dhe është në gjendje të dëmtojë besimin e publikut në sistemin e të drejtës penale. Në rastet që përfshijnë më shumë të pandehur bazat e deklarimit për secilin të pandehur duhet të përputhen faktikisht me njëra tjetrën”.

Pavarësisht a janë apo jo të “të miratuara” deklarimet, gjykatësi nuk është i obliguar me këtë marrëveshje dhe ai mund të insistojë që çfarëdo dëshmie që është relevante lidhur me ndonjë fakt të kontestit, ose për të cilin gjykatësi mund të kërkojë informacion shtesë, ato të shqyrtohen.

Gjyqi duhet të jetë i informuar nëse kontesti faktik nuk mund të zgjidhet. Sipas Direktivës së Prokurorit Publik:

”Kur baza e deklarimit nuk mund të miratohet dhe mospërputhja mes dy palëve është aq sa të ketë mundësi të ketë efekt të konsiderueshëm në shkallën e dënimit, detyrë e avokatit mbrojtës është të informoj gjyqin, para se të fillojë procesi i shqiptimit të dënimit. Mbetet një detyrë thelbësore për avokatin e prokurorisë që të sigurojë vallë gjykatësi që shqipton dënimin është i njoftuar për mospërputhjen ekzistuese dhe se a duhet marrë në konsideratë atë se patjetër të mbahet dëgjimi Newton për të zgjidhur rastin. Gjykatës duhet t’i tregohet kur nuk është i pranueshëm një referim

<sup>26</sup> Pika C5 e Udhëzimeve të Ministrisë të Drejtësisë për pranim faji.

nënçmues ndaj viktimës, dëshmitarit apo palës së tretë, edhe pse kjo mund të mos ndikojë në dënimin e shqiptuar”.

“Në të gjitha rastet ku është e mundshme të ndihmohet gjyqi në rastet kur çështjet e shqiptimit të dënimit janë komplekse ose jo të njohura, prokuroria duhet të shtojë një përmbledhje të vështrimeve kryesore në planin me shkrim të rasteve të cilat i dorëzohen gjykatës.

Kjo duhet të ketë formën e shënimeve të shkurtra për: - çdo kufizim statusor relevant – emrat e autoriteteve për shqiptim të dënimit ose direktivat – diapazoni i ndonjë urdhri ndihmës (p.sh. në lidhje me sjellje kundër shoqëris, konfiskim ose deportim) duhet të merret në konsideratë. – Plani gjithashtu duhet të përfshijë moshën e të pandehurit dhe informacione lidhur me ndonjë kundërvajtje të veçantë.”

#### 2.4. Dëgjimi gjyqësor në lidhje me kontestimin e fakteve për pranimin e fajësisë- “Dëgjimi i Newton-it”

Në rast se palët nuk mund të zgjidhin një kontest faktik gjatë tentimit të arritjes së marrëveshjes për deklarim të fajësis, prokuroria duhet të vendosë vallë rasti duhet të vazhdojë në seancë gjyqësore ose të ftohet gjyqi të mbajë një dëgjim sipas nevojës. Gjyqi mund të mbajë një dëgjim për të zgjidhur kontestin lidhur me faktet që rezultojnë nga deklarimi i fajësisë. Kjo është procedurë e ligjit zakonor pa origjinë statusore, që buron nga rasti i vitit 1982 *R.kundër Newton-it*<sup>27</sup> dhe i njohur si “Dëgjimi i *Newton-it*. Kur prokurorit i mungojnë dëshmitë për të kontestuar pozitivisht shpjegimin e të pandehurit, për shembull në rast se i pandehuri pohon një çështje jashtë njohurisë së prokurorisë, ajo mund të kërkojë të testojë dëshminë e të pandehurit me kërkim të dëgjimit- *Newton*.

Gjykata ka të drejtë të sjell konkluzion të vetin për faktet e bazuara në dëshmi kur as prokurori as mbrojtja nuk kanë ftuar Gjykatën të mbajë një dëgjim *Newton* dhe kontesti faktik ka mundësi të ketë ndikim material në dënim. Kur çështja e kontestuar ka të bëjë me faktet që janë në dijeni ekskluzive të të pandehurit dhe kur i pandehuri dëshiron të japë dëshmi, atëherë i pandehuri duhet t bëjë këtë gjë. Në rast se i pandehuri nuk dëshiron të japë dëshmi dhe nga çfarëdo shpjegimi që mund të jepet – gjykatësi mund të nxjerrë konkluzione adekuate gjatë dhënies së dënimit.

<sup>27</sup> R kundër Newton (1982), R.13

Kur i pandehuri deklarohet fajtor, por kundërshton faktet e prokurorisë, bazat e deklaramit e të pandehurit duhet bërë me shkrim, duke bërë identifikimin e kundërshtimit. Gjykata mund të ftojë palët të shprehen, nëse kontesti është i rëndësishëm për dënimin. Nëse gjykata vendos se ai është i rëndësishëm, ajo pastaj fton prezantim të mëtejme të dëshmive dhe vendosë lidhje me kontestin në bazë të principit *Newton*.

### **2.5. Rastet që përfshijnë mashtrim të rëndë – deklarimi i fajësisë sipas bazës së, miratuar nga ana e prokurorisë dhe mbrojtjes, e përcjellë nga paraqitjet e përbashkëta për dënimin**

Kjo është kategoria e tretë e identifikuar në Udhëzimin e praktikave të bashkuara kriminale dhe aplikohet, kur prokuroria dhe i pandehuri në një rast të mashtrimit të rëndë ose kompleks janë pajtuar për një bazë të deklaramit dhe kërkojnë të bëjnë një paraqitje në gjykatë në lidhje me dënimin. Në këto raste, baza me shkrim e deklaramit të fajësisë e arritur ndërmjet prokurorit dhe avokatit mbrojtës në fakt quhet “marrëveshje për pranimin e fajësisë”<sup>28</sup>

Udhëzimit të praktikave të bashkuara kriminale bën definimin e zbatueshmërisë së saj. Prokurori Publik edhe drejtori i Prokurorisë Publike kanë publikuar, po ashtu, udhëzime të zbatueshme<sup>29</sup> për këto raste Mund të mbahen diskutime gjatë fazës së hetimeve para se të shqiptohen akuzat që mund të rezultojnë në akuza të ndryshme nga ato të preferuara pa marrëveshje. Çdo marrëveshje duhet të jetë “e arsyeshme, e drejtë dhe korrekte dhe se duhet të ketë sigurim për të siguruar se të pandehurit nuk janë nën ndonjë presion të padukur për të bërë pranimin.” Duhet të mbahen shënimet nga këto diskutime.<sup>30</sup>

Marrëveshjes për pranim të fajit duhet të pasqyrojë rëndësinë dhe shkallën e kundërvajtjes, t'i japë gjykatës kompetencat adekuate për shqiptim të dënimit, dhe t'i mundësojë gjykatës, opinionit dhe viktimave të kenë besim në rezultatin përfundimtar. Prokurori duhet me kujdes ta merr në konsideratë ndikimin e deklaramit apo të bazës së deklaramit të propozuar në komunitet dhe në viktimë, dhe në të perspektivën e ndjekjes penale të suksesshme të ndonjë personi

<sup>28</sup> Shih paragrafi IV 45, Udhëzimi i praktikave të bashkuara kriminale

<sup>28</sup> Paragrafi 45, Udhëzimi i praktikave të bashkuara kriminale Udhëzimet e Prokurorit Publik për Bisedat për deklarim në rastet e mashtrimeve të rënda dhe komplekse, me 18 mars 2009, Udhëzuesi i Drejtorëve për të shoqëruar Udhëzimet e Prokurorit Publik për Bisedat për deklarim në rastet e mashtrimeve të rënda dhe komplekse”.

<sup>30</sup> Paragrafi A5, A6 dhe A7, Udhëzimet e prokurorit publik lidhur me bisedat për deklarim të fajit në rastet e mashtrimeve të rënda dhe komplekse.

tjetër të implikuar në kundërvajtje. Prokurori nuk guxon të pajtohet me bazën e zvogëluar të deklaramit e cila është çorientuese, jo e vërtetë dhe jo-logjike”:

Për më tepër “prokurori duhet patjetër të mos ushtrojë presion të gabuar tek i pandehuri gjatë bisedave për deklarim të fajit, për shembull me ekzagjerim të rastit me qëllim që të bindet i pandehuri për deklarim të fajësisë ose të deklarohet fajtor në baza të veçanta.” I pandehuri duhet të kenë informacion të mjaftueshëm për ta mundësuar atë të luaj një rol me njohuri të plotë gjatë bisedave për deklarim.<sup>31</sup>

Procedurat në këto raste dallojnë në aspektin se palët duhet të sigurojnë shumë më tepër materiale për gjykatësin, edhe atë, së paku, shtatë ditë para paraqitjes së parë të pandehurit në Gjykatën e lartë. Kjo përfshinë (I) marrëveshjen për pranim të fajit, deklarim; (II) paraqitjet për dënimin; (III) tërë materialin e siguruar gjatë bisedës për deklarim nga ana e prokurorisë për të pandehurin; (iv) materiale relevante të siguruar nga ana e të pandehurit, për shembull dokumentet në lidhje me lehtësimet personale; dhe (v) procesverbalin e çdo takimi mes palëve dhe çdo korrespondencë që buron nga bisedat për deklarim të fajit. Gjykatësi mund të kërkojë materiale shtesë.

Për shkak të natyrës së këtyre llojeve të kundërvajtjeve, gjykata duhet të marrë parasysh kohëzgjatjen nga momenti i kryerjes së kundërvajtjes, kohën e shpenzuar për intervistimin e të pandehurit, datën e akuzës dhe datën e seancës gjyqësore në perspektivë, me qëllim që të sigurojë koha e duhur për shqyrtimin e marrëveshjes së deklaramit dhe paraqitjeve për dënim mos të shkaktojnë shtyrje të panevojshme kohore. Palët mund të dorëzojnë paraqitjen e tyre të përbashkët. Gjykata mund t'i refuzojë ato në tërësi dhe gjykatësi mund të refuzojë të pranojë marrëveshjen për deklarim dhe të caktojë dënimin ndryshe nga ajo e miratuara në paraqitjet për dënim të bërë sipas Udhëzimeve të Prokurorit Publik në bisedat për deklarim.

Paraqitjet për dënim duhet të tërheqin vëmendjen e gjykatës për çdo shkallë të aplikueshme të dënimin në çfarëdo udhëzimi relevant dhe të çfarëdo urdhri plotësues, i cili mund të jetë i aplikueshëm. Paraqitjet për dënim nuk duhet të përfshijnë ndonjë dënim të veçantë ose ndonjë shkallë të miratuar ndryshe nga shkallët e dënimin të parapara në direktiva apo nga autoritetet.

<sup>31</sup> Paragrafët B1, B2, B3 dhe B4, Udhëzimet e prokurorit publik lidhur me bisedat për deklarim të fajit në rastet e mashtrimeve të rënda dhe komplekse.

Para se të deklarohet fajtor në përputhje me marrëveshjen për pranim të fajit, i pandehuri mund të kërkojë të dhëna për dënimin për të pasur dijeni për dënimin maksimal të mundshëm (shih mëposht). Marrëveshja për pranim të fajit ngelë obliguese, madje edhe atëherë kur gjykatësi jep shenja për dënimin ose miraton dënim që nuk është në përputhje me paraqitjen e bërë për dënim.

Në rast se i pandehuri nuk deklarohet fajtor në përputhje me marrëveshjen për deklarim ose nëse i pandehuri i cili deklarohet fajtor në përputhje me marrëveshjen për deklarim me sukses aplikon për tërheqje të deklarimit të vet, marrëveshja e firmosur për deklarim mund të trajtohet si dhënie rrëfimi për dëshmi dhe mund të përdoret kundër të pandehurit në ndonjë fazë të mëvonshme në këtë seancë gjyqësore apo ndonjë tjetër<sup>32</sup>. Gjykata ka të drejtë diskrecioni të mos e pranojë atë në dosje të dëshmive, e nëse e bën këtë, atëherë mundet në mënyrë të pafavorshme të ndikojë në paanësinë e seancës gjyqësore.<sup>33</sup>

## 2.6. Indikacion mbi dënimin që jepet paraprakisht - rasti Goodyear

Para se të deklarohet fajësinë i pandehuri mund të kërkojë nga gjykata një paralajmërim për dënimin maksimal që mund t'i shqiptohet nëse ai ose ajo deklarohet fajtor në atë fazë të procesit gjyqësor. Paralajmërim për dënimin mund të kërkohe vetëm nga Gjykata e Lartë.

Paralajmërimi i dënimit është një procedurë e ligjit zakonor i cili nuk është i rregulluar me statut. Udhëzimet burojnë nga rasti i vitit 2005 i Gjykatës së Apelit *R. kundër Goodyear*.<sup>34</sup> Direktivat e Prokurorit Publik gjithashtu sigurojnë udhëzime. Kur është e përshtatshme, duhet patjetër të ketë një bazë për deklarim të shprehur me shkrim.

Pasi që të dëgjojë palët, gjykatësi mund të japë një paralajmërim duke treguar për dënimin që do të shqiptohet në bazë të deklarimit të fajësisë. Gjykatësi gjithashtu mund të informojë të pandehurin se lloji dhe kohëzgjatja e dënimit mund të ishin të njëjta po që se rasti shkonte në seancë gjyqësore.

Gjykatësi, gjithashtu, mund të refuzojë ose të shtyjë për tjetër herë kërkesën. Gjykata zakonisht nuk duhet të japë paralajmërim kur ekziston ndonjë kontest në bazë të deklarimit, përveç se në rast se gjykatësi sjell përfundim se ai ose

<sup>32</sup> Rregulla 39.3 në Rregullat e procedurës penale

<sup>33</sup> Paragrafi 45.27, Udhëzimi i praktikave të bashkuara kriminale

<sup>34</sup> R. Kundër Goodyear [2005] 2 Crim. App. R. 20 (Gjykata e Apelit), 3 All ER 117, shih gjithashtu paragrafët 45.29-29.33 të Udhëzimit të Praktikave të Bashkuara Kriminale.

ajo mund të merren me rastin në mënyrë adekuate pa pasur nevojë për dëgjimin *Newton*. Në rast se ekziston kontest me faktet, atëherë duhet përcjellë procedurën, siç referohet më lartë në rastin e *R. kundër Underwod-it* para se gjykata të paralajmërojë dënimin.

Direktiva e Prokurorit Publik thotë se paralajmërimet lidhur me dënimet nuk duhet të kërkohen nga gjykatësi i lëndës, përveç rasteve kur çështjet mes prokurorisë dhe mbrojtjes janë adresuar dhe janë zgjidhur. Prokurorët, po ashtu, nuk duhet të pajtohen për bazën e deklaramit, nëse nuk i kanë bërë konsultimet e nevojshme me viktimën dhe me familjen e tij. Gjykata e Apelit konsideron se gjykatësinuk duhet të trajtojë procesin si “marrëveshje për pranimin e fajit” ose të jetë e involvuar në çfarëdo forme të marrëveshjes për pranim të fajit.<sup>35</sup>

Kur të jepet deklarimi atëherë ai është obligues për gjykatësin dhe për secilin gjykatës tjetër i cili do të jetë përgjegjës për rastin kur i pandehuri vendosë të deklarohet fajtor. Pas paralajmërimit të dhënë për dënimin, në rast se i pandehuri nuk deklarohet fajtor, paralajmërimi nuk është ende obligues për gjykatën.

Prokurori ka një rol aktiv në këtë proces. Kur është e përshtatshme ai ose ajo duhet të ndihmojnë gjykatën në shqiptimin e dënimit, për referenca në kompetenca relevante statusore të gjykatës, udhëzime dhe autoritete relevante për shqiptim të dënimeve, si dhe të gjitha ndihmat të cilat gjykata mund t'i kërkojë.

Prokurori e ka të ndaluar të thotë “*çfarëdo që do të mund të krijonte përshtypjen se paralajmërimi i dënimit ka mbështetjen ose miratimin e gjykatës së Lartë*”<sup>36</sup> si dhe mund të mos japë pëlqim për miratim të dënimit edhe atëherë kur prokuroria ka bërë paraqitje për dënimin të përbashkët me mbrojtjen.

Paralajmërim si i *Goodyear-it* duhet të jepet në gjykatë të hapur në praninë e të pandehurit, por çfarëdo reference për dëgjimin nuk do të jetë e pranueshme në asnjë proces gjyqësor pasues. Në këtë kuptim gjykata duhet të vendosë restriksione për raportim nga mediat.<sup>37</sup>

Paralajmërimi nuk obligon Gjykatën e Apelit nëse prokuroria ankohet kundër uljes së dënimit.<sup>38</sup>

<sup>35</sup> Paragrafi 67 R. kundër *Goodyear*

<sup>36</sup> Paragrafi 70 (d) R. Kundër *Goodyear*.

<sup>37</sup> Paragrafët 76-77 R. kundër *Goodyear*

<sup>38</sup> Referenca e Prokurorit Publik nr. 40 e vitit 1996 [1997] 1 Crim. App. R 357

## 2.7. Zvogëlimi i dënimit për premtim për asistimin e autoriteteve

Të pandehurit të cilët deklarohen fajtorë dhe asistojnë autoritetet kanë të drejtë të fitojnë zvogëlim të dënimeve të tyre. Ky është rezultat i zakonshëm i një negocimi për deklarim. Kjo justifikohet në bazë të interesit publik për zvogëlimin e dënimit të atyre që japin dëshmi për prokurorinë, në veçanti, duke ditur që ato mund të jenë në rrezik fizik. I pandehuri mund të fitojë zbritje të dënimit edhe atëherë kur ai ose ajo nuk janë deklaruar fajtor.<sup>39</sup>

I pandehuri i cili hyn në marrëveshje të shkruar me prokurorinë për të dhënë asistencë hetuesit ose prokurorit mund të fitojë zbritje të dënimit me kusht që ai ose ajo të deklarohet fajtor para Gjykatës së Lartë.<sup>40</sup> I pandehuri nuk e ka patjetër të deklarohet fajtor para se të hyn në fazën e marrëveshjes me shkrim me prokurorinë. Asistenca mund të jetë në formë të dhënies dëshmi ose informacion tjetër siç është inteligjenca. Gjykata e Apelit ka lëshuar udhëzim për interpretim të këtij seksioni.<sup>41</sup>

Prokurori duhet t'i japë gjykatës raport që cekë sasinë dhe cilësinë e asistencës së dhënë, rezultatet që dalin nga ajo (p.sh. arrestimet ose ndjekjet penale që drejtpërdrejtë i atribuohen informacionit së të pandehurit) dhe një vlerësim të rrezikut me të cilin ballafaqohen i pandehuri dhe familja e tij ose saj si rezultat i bashkëpunimit.

Zvogëlimi i dënimit nuk është i detyrueshëm, dhe gjatë caktimit të dënimit adekuat gjykata mund të marrë parasysht shkallën dhe natyrën e asistencës së dhënë ose të ofruar. Zvogëlimi mund të jetë si shtesë në zvogëlimin që normalisht jepet për deklarim të hershëm të fajësisë, përfshirë këtu dënimet minimale statusore.

Prokurori mund të kthen rastin prapa në gjykatë për rishqyrtim të dënimit në rast se i pandehuri me qëllimisht dështon ("në çfarëdo shkalle") të japë asistencën e premtuar dhe gjykata mund të rritë dënimin. Edhe anasjelltas, prokurori mund të kthejë rastin prapa, nëse i pandehuri ofron asistencë shtesë pas dënimit ose nëse nuk është ofruar kurrfarë asistence, e më pas jep ose ofron asistencë. Gjykata mund të zvogëlojë dënimin origjinal.<sup>42</sup>

<sup>39</sup> R kundër A(2006) EWCA Crim 1803 dhe kundër H, D, Chaundhury (2009) EWCA 2485

<sup>40</sup> Seksioni 73 nga Akti policor dhe për krime të organizuara të rënda 2005.

<sup>41</sup> R. Kundër P dhe Blackburn [2007] EWCA Crim 2290.

<sup>42</sup> Seksioni 74 i Ligjit mbi Krimin e Organizuar dhe Policinë, 2005.



## 2.8. Roli i prokurorit

Prokurori duhet t'i bindet "Direktivave të Prokurorit Publik për pranimin e deklaramit dhe Roli i Prokurorit në Dhënien e Dënimit". Drejtori i Prokurorisë Publike po ashtu duhet t'i bindet Kodit për Prokurorët e Lartë "Pranimi i Deklaratave të Fajësisë". Ai cekë se "Prokurorët duhet të pranojnë deklaratën e të pandehurit vetëm në rast kur mendojnë se gjykata është e aftë të shqipton një dënimi i cili përputhet me seriozitetin e kundërvajtjes, në veçanti kur ekzistojnë tipare rënduese. Prokurorët kurrë nuk duhet të pranojnë një deklaramit të fajësisë vetëm për arsye se ajo është e volitshme.<sup>43</sup> Gjatë vendosjes nëse të pranohet apo jo deklaramit për disa kundërvajtje ose për disa më të lehta për arsye se i pandehuri pranon vetëm një pjesë të krimit prokurori duhet të sigurojë që interesat dhe pikëpamjet e viktimës janë marrë në konsideratë gjatë vendosjes nëse pranimi i deklaramit është në interes të publikut. Vendimi i takon vetëm prokurorit.

Prokurori mund të pajtohet të dënohet i pandehuri në bazë të asaj se disa kundërvajtje janë marrë parasysh para se ato të shqyrtohen veçmas, që do të thotë se kundërvajtjet janë hedhur poshtë. Procedura e gjykatës për marrje parasysh të kundërvajtjeve gjatë dhënies së dënimit nuk ka bazë statusore por për kohë të gjatë është pjesë e regjimit të dhënies së dënimit.<sup>44</sup>

Prokurorët duhet "të jenë vigjilentë ndaj të pandehurve të cilët kërkojnë të deklarojnë fajësinë për kundërvajtje më të lehta të cilat mund të mos tërheqin detyrimisht dënim minimal", në veçanti për shkak të urdhëresave ndihmëse (dëmshtëpërlim, kompensim, etj.) një gjë e tillë nuk mund të bëhet me disa kundërvajtje.<sup>45</sup> Nga prokurori kërkohet "që të tërheqë vëmendjen e gjykatës për çfarëdo deklarate personale të viktimës ose informacion për ndikimin e kundërvajtjes ndaj viktimës, ndikimin në komunitet (kur është e përshtatshme), për dispozitat statusore relevante për të pandehurin dhe kundërvajtjet, dhe për çdo faktor rëndues ose lehtësues.<sup>46</sup>

Prokurori duhet të ia bën "të qartë gjykatës në çfarë baze ndonjë deklaramit ka kaluar dhe është pranuar. Në rastet kur i pandehuri deklarohejt fajtor për akuzat, por në bazë të fakteve të cilat dallojnë nga rasti i prokurorisë, dhe kur kjo mund të ndikojë me plot kuptim dënimin, gjykata duhet të ftohet për të

<sup>43</sup> Paragrafi 10.1, Kodi i Prokurorëve të Lartë "Pranimi i Deklarimeve të Fajësisë"

<sup>44</sup> Në juridiksionet tjera të ligjit zakonor, siç është Australia, kjo është e pranuar dhe e rregulluar me statut.

<sup>45</sup> Paragrafi 10.6 nga Kodi i Prokurorëve të Lartë "Pranimi i deklarimeve të fajësisë".

<sup>46</sup> Paragrafi B4 e Udhëzimeve të Ministrit të Drejtësisë.

dëgjuar dëshminë që të përcaktojë se çfarë ka ndodhur, dhe pastaj të jep dënimin në bazë të saj”.<sup>47</sup>

Nëse i pandehuri refuzon të pranojë një kundërvajtje në gjykatë për të cilën ai ose ajo më parë kanë thënë se duhet të merret në konsideratë gjatë shqiptimit të dënimit, prokurori patjetër duhet të shqyrtojë nëse prokuroria është e denjë për atë kundërvajtje.

Po ashtu kërkohet nga prokurori që të sfidojë çdo pohim të mbrojtjes për zbutjen nënçmuese të karakterit të personit edhe nëse është i rrejshëm apo jo relevant për procedurën gjyqësore të dhënies së dënimit. Kërkohet nga mbrojtja të bëjë njoftim paraprak me shkrim për një qëllim të tillë, për t’i lejuar prokurorit kohë për ta hetuar dënimin, siç janë.<sup>48</sup>

Përveç këtyre udhëzimeve dhe kodeve, Kodi për veprim i avokatëve gjithashtu parashtron detyrat e këshillit të prokurorisë në gjykatë në lidhje me dënimin, siç janë,<sup>49</sup>

- të mos tentohet që përmes mbrojtjes të ndikohet në Gjykatë sa i përket dënimit;
- të informohet Gjykata për çdo rrethanë lehtësuese për të pandehurin e papërfaqësuar;
- të asistohet në Gjykatë nëse një gjë e tillë kërkohet sipas dispozitave relevante për kundërvajtjen apo të pandehurin dhe udhëzime relevante për dënimin;
- të informohet Gjykatë për këto çështje nëse zotëron një opinion se Gjykata ka gabuar;
- të informohet Gjykata për çdo çështje të kompensimit, konfiskimit apo dëmshpërblimit të përshtatshëm;
- të informohet mbrojtja për çdo pohim të faktit material të bërë për lehtësim për të cilin prokuroria beson të mos jetë i vërtetë dhe, nëse mbrojtja insiston, të ftohet Gjykata të mbajë një dëgjim *Newton*.

## 2.9. Roli i avokatit mbrojtës

Roli i avokatit mbrojtës është i përcaktuar në Standardet e shkruara të Kodit për veprim të avokatëve i cili thotë,<sup>50</sup>

<sup>47</sup> Paragrafi 10.4 nga Kodi i Prokurorëve të Lartë Publik “Pranimi i Deklarimeve të Fajësisë”.

<sup>48</sup> Paragrafët E1 dhe E20 nga Direktivat e Prokurorit Publik për pranimin e deklarimit.

<sup>49</sup> Paragrafi 10.8 i Kodeksit për Etikë i përfaqësuesve ligjorë nga Anglia dhe Uells, standarde të punës profesionale, botimi VII, 2004.

<sup>50</sup> Paragrafi 11.3 dhe 11.4 nga Kodi për veprim

“Një avokat i cili punon për të pandehurin duhet të këshillojë klientin në përgjithësi në lidhje me deklarin e tij. Duke bërë këtë ai, po ashtu, mundet, nëse ka nevojë, të shprehë këshillën e tij në formë të kushteve rigoroze. Megjithatë, ai duhet të bëjë të qartë se klienti i tij ka liri të plotë të zgjedhjes dhe se përgjegjësia për deklarin ngelë te klienti.

Një avokat që ushtron detyrën për të pandehurin duhet të këshillojë klientin e vet nëse duhet ose jo të japë dëshmi për mbrojtje të vetvetes, mirëpo rapë vendimin duhet ta marrë vetë klienti.”

### 2.10. Roli i viktimave dhe familjeve të tyre në procesin e deklarin

Prokurori duhet të bisedojë me viktimën ose familjen e tij për të shpjeguar vendimin për pranimin e deklarin ose për të ofruar dëshmi për aktakuzën ose ndonjë pjese të saj. Prokurori duhet të informojë viktimën ose familjen e tij tërë kohën.<sup>51</sup> Viktima mund të jep “deklaratën personale të viktimës” e cila iu lejon atyre të tregojnë ndikimin që ka bërë kundërvajtja në ta. Në disa rrethana, siç janë vdekja e viktimës, atëherë dikush nga familja mund të japë deklaratë.

Gjatë procesit të shqiptimit të dënimit prokurori duhet të tërheqë vëmendjen e gjykatës për çdo deklaratë personale të bërë nga viktima ose informacion për ndikimin e kundërvajtjes ndaj viktimës, e në momente të përshtatshme edhe ndikimin kundërvajtjes në komunitet.<sup>52</sup>

## 3. ITALIA

### 3.1. Hyrje

Kodi i procedurës penale i vitit 1988 (*Code di Procedura Penale*) formalisht e paraqet sistemin e “marrëveshjes për deklarin” në sistemin italian e drejtësisë penale.

Në kohën kur kodi i ri u paraqit ai ishte përshkruar si një “revolucion” edhe për shkak të zëvendësimit të gjykatësit hetues me një kornizë të re procedurale dhe për paraqitjen e proceseve kundërshtuese në një sistem të së drejtës civile

<sup>51</sup> Paragrafi B3 nga Direktivat e prokurorit publik.

<sup>52</sup> Paragrafi B4 nga Udhëzimet e Prokurorit Publik, *Udhëzim nga Praktika (Ndjekja Penale: Përmbledhje)* [2002] 1 W.L.R. 2870; [2009] 1; W.L.R. 1396.

tradicionale.<sup>53</sup> Komentuesit sqarojnë thonë se si model akuzues/kundërshtues ishte parë si një rrugë për “hapjen’ e sistemit të drejtësisë penale të Italisë për të “pasqyruar statusin e vet si një sistem bashkëkohor, një shoqëri demokratike” dhe ta furnizojë atë me procedura të reja dhe efikase për përmirësimin e problemit të vet të mbingarkimit gjyqësor.”<sup>54</sup>

Megjithatë, një sistem i tipit kundërshtues – madje edhe gjatë mbajtjes së veçorive inkuizitore – në praktikë nuk mund të funksiononte pa shmangur një përqindje të konsiderueshme të rasteve nga seancat gjyqësore. Seancat kundërshtuese mund të jenë të gjata dhe të shtrenjta. Për këtë arsye, në linjë të procedurave të ligjit zakonor janë paraqitur alternativa të seancave gjyqësore për të tentuar të zvogëlohen shpenzimet e gjykimeve kundërshtuese të kushtueshme, meqë për shkak të kohëzgjatjes dhe harxhimit shumica e rasteve janë lëshuar në vend se t’i nënshtrohen një gjykimi të plotë.

Edhe Kodi i Procedurës Penale edhe Kushtetuta e bëjnë të obligueshëm procesin gjyqësor kundërshtues. Sidoqoftë, neni 111 (5) i Kushtetutës lejon largimin nga procesi kundërshtues në rast se i pandehuri pajtohet për një gjë të tillë dhe, ligji lejon disa mënyra për vendosjen e fajësisë dhe arritjen deri te dhënia e dënimit në mënyrë më të shkurtër se një gjykim i plotë kundërshtues. Këto janë “marrëveshjet për pranimin e fajit”, seanca të përmbledhura “*giudizio abbreviato*” dhe seancë sipas “dekretit gjyqësor.”

Procesi i marrëveshjes së prezantuar për pranim të fajit dallon mjaft nga ai në Shtetet e Bashkuara, për shembull, atëherë kur llogaritet se deri në 90% të rasteve në disa juridiksione zgjidhen me ndonjë nga format e marrëveshjes për deklaram. Në Itali, për dallim nga Shtetet e Bashkuara, marrëveshja për deklaram të fajit ndodh gjatë fazës së dëgjimit preliminar, dhe kur mbrojtja ka pasur mundësinë të shqyrtojë dosjen e hetimit duke mundësuar kështu një zbulim të plotë të rastit në ndjekje penale. I pandehuri kështu në bazë të informacionit që ka marrë mund të bie një vendim nëse do të kërkojë të bëhet një marrëveshje për deklaram të fajit.

<sup>53</sup> Shih p.sh. Miller, Jeffrey J. *Marrëveshja për deklaram dhe analogjitë e saj sipas ligjit të ri italian, Kodi i Procedurës Penale në SHBA: drejt një kuptimi të ri të procedurës penale krahasuese [1989-1990]* 22, Zhurnali i Ligjit dhe Politikave Ndërkombëtare i New York University, 215 në 215, cituar nga raportet e mediave prezantuar në vitin 1989.

<sup>54</sup> Elisabetta Grande *Italian Criminal Justice: Borrowing and Resistance*, 48 Am. J. Comp. L. 227 (2000) në 231.

## 54

Tipare tjera të rëndësishme (dhe dallime) janë ato se palët nuk bien në ujdë për natyrën e krimit, zvogëlimi maksimal i dënimit është deri në 5 vjet burgim, kështu që në mënyrë domethënëse zvogëlohet mundësia e kësaj. I pandehuri mund poashtu të kërkojë zvogëlim në shkallë të një të tretës së dënimit, madje edhe atëherë kur prokuroria nuk i bashkëngjitet kërkesës. Kështu i pandehuri, në të vërtetë, nuk deklarohet i fajshëm në mënyrë të sistemeve kundërshtuese të ligjit zakonor.

Sistemi italian, gjithashtu, dallon me shfaqjen e një kombinimi të shtyrjeve të rëndësishme gjatë sjelljes së rasteve para gjyqit dhe me kufizime kohore rigorozë statusore për fillimin dhe mbarimin e rasteve. Prokurorët amerikanë, për dallim, kanë ndikim shumë më të madh në rezultatin e procesit, meqë sistemi nuk ndalon mbi-akuzimin, e për këtë jep inkurajim për marrëveshje deklarim të fajit.

Kështu, në Itali, për dallim nga Shtetet e Bashkuara, interesimi i të pandehurit mundet më mirë të plotësohet me dërgimin e rastit në procedurë gjyqësore deri sa është i liruar me depozitim dhe të presë për mbarimin e kufizimit kohor statusor për sjelljen e aktakuzës se sa të hyjë në negociata për deklarim të fajit me prokurorin. Sidoqoftë, pasi dënimet me më pak se dy vjet në përgjithësi janë ndërprerë, ekzistojnë disa shtytje që të shmangët burgosja duke aplikuar marrëveshjen për praninë të fajit.

Shtyrjet e seancave gjyqësore në Itali mund të jenë shumë të vështira. Një rast tipik kalon afër 400 ditë në zyrën e Prokurorit. Dëgjimi preliminar mbahet, më së paku, pas 300 ditëve. Për seanca gjyqësore para tribunalit nevojiten edhe 350 ditë të tjera.<sup>55</sup>

Për dallim nga për shembull Bosnjë e Hercegovina – e cila gjithashtu ka marrëveshje deklarimi të fajit në kushtetutë - seanca kryesore duhet patjetër të fillojë brenda 30 ditëve (ose 60 ditë me zgjatje) prej kohës së hyrjes së deklarimit.<sup>56</sup>

<sup>55</sup> 2003: Raporti i Prokurorit Kryesor të Gjykatës Supreme

<sup>56</sup> Neni 229 nga Kodi i Procedurës Penale 1998.

### 3.2. Marrëveshja për deklarim të fajit- “Dënimi me kërkesë të palëve” “*l’applicazione della pena su richiesta della parti*” – ose *patteggiamento* ose “marrëveshje”

Dënimi me kërkesë të palëve përshkruhet si një “formë e butë e marrëveshjes për deklarim” dhe zakonisht quhet *patteggiamento*, ose “ujdi” ose “marrëveshje” në anglisht. Fillimisht kjo ishte e kufizuar vetëm për krime të dënueshme për jo më shumë se tre vjet. Në vitin 2003 një amendament legjislativ e zgjeroi këtë edhe për krime të dënueshme me deri në pesë vjet burgim.<sup>57</sup>

Marrëveshja për deklarim të fajit mund të mos përdoret në të gjitha rastet që tërheqin dënime deri në pesë vjet, për shembull, kundërvajtjet që përfshijnë pornografi, pedofili, ngacmim seksual, dhe krime të rëndomta ose profesionale, apo ato që kanë “tendencë kriminale”.<sup>58</sup>

Kjo procedurë mund të shfrytëzohet në seancën paraprake pas përmbylljes së fazës së hetimit. Në shqyrtimin para seancës paraprake, gjykatësi gjudice për l’udienza preliminare (*gup*) dhe para parashtrësive përmbyllëse, mbrojtja dhe prokurori mund të kërkojnë nga gjykatësi të aplikojë zvogëlim të negociuar të dënimit në jo më shumë se pesë vjet burgim, e cila përfshin një të tretën e zvogëlimit të dënimit normal. Kohëzgjatja e zvogëlimit është shumë e rëndësishme për të pandehurin kur kihet parasysh se dënimet nën 4 vjet mund të hiqen.

Palët duhet të dakordohen për dënim para prezantimit të marrëveshjes para gjykatësit.<sup>59</sup> Në praktikë, palët, përfshi të pandehurin, mund të negociojnë dënimin në prezencë të *gup-it* (në zyrën e tij), i cili poashtu mund të marrë pjesë në mënyrë joformale, I pandehuri mund të heq dorë nga obligimi për të marrë pjesë me shkrim.

Pas pranimit të kërkesës, “*gup*” e shqyrton dosjen e hetimit dhe vendosë nëse i pandehuri është i pafajshëm ose do të mund të lirohet sipas nenit 129 (nuk është kryer kurrfarë kundërvajtje, ose i pandehuri nuk e ka kryer atë, ose kundërvajtja është e mbyllur me kohë sipas statutit). Nëse jo, gjykatësi verifikon nëse rasti është trajtuar në mënyrë të përshtatshme me marrëveshje për deklarim të fajit dhe nëse palët kanë aplikuar principet në mënyrë të saktë për

<sup>57</sup> Nenet 444 deri 448 nga Kodi i Procedurës Penale 1988.

<sup>58</sup> Nenet 446 dhe Art 600 bis – *quinquies* dhe 609 bis – *octies*

<sup>59</sup> Neni 444 nga Kodi i Procedurës Penale 1988

baraspeshimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese gjatë kërkimit të dënimit të negociuar<sup>60</sup>.

Kjo bëhet pa marrëveshje formale për deklarim të fajësisë. Në Shtetet e Bashkuara, për dallim, palët mund të pajtohen për një dënim por, gjithmonë me deklarim të fajësisë.

Gjykatësi nuk mund të ndryshojë dënimin bashkërisht të miratuar dhe të shqiptojë dënimin e dakorduar mes palëve , por nuk mund të ndryshojë dënimin bashkërisht të miratuar dhe të shqiptojë një tjetër më të lehtë apo më të rëndë.

Në rast se gjykatësi refuzon kërkesën dhe e dërgon rastin në seancë gjyqësore, palët mund të aplikojnë përsëri për një *patteggiamento* në fillim të seancës.

Përkundër synimit fillestar parlamentar se kjo procedurë duhet shpesh të shfrytëzohet, vetëm rreth 15% të rasteve janë zgjidhur sipas kësaj metode të marrëveshjes për deklarim. Sa për ilustrim, mes vitit 1990 dhe 1998, 17 deri 21% të rasteve në gjykatat për kundërvajtje dhe mes 34 dhe 42% në gjykatat e nivelit të dytë e kanë përdorur këtë metodë.

### 3.3. Procedurat përmbledhëse “*il giudizio abbreviato*”

I pandehuri mundet gjithashtu të heq dorë nga e drejta në gjykim dhe të kërkojë shqyrtim para “gup” duke u bazuar në argumentin në dosjen e hetimit të prokurorisë. Kjo njihet si procedurë përmbledhëse ose gjykim i shkurtuar “*il giudizio abbreviato*”. Kur rasti shqyrtohet nga gjykatësi i vetëm pa përfshirjen e “gip” apo “gup”, para se të fillojë shqyrtimi, i pandehuri mund të kërkojë një “*abbreviato*” para gjykatësit të rastit.<sup>61</sup>

I pandehuri mund të mirret në pyetje gjatë një “*abbreviato*” dhe mund të prezantojë argument të ri që do të mirret parasysh në dosjen e hetimit. Mbrojtja mundet poashtu të angazhohet me kusht të pranojë konkluzionet nga dosja e hetimit, por vetëm pasi prokuroria ka zhvilluar hetime të veçanta plotësuese. Prokurori mund vetëm të kërkojë që dëshmitë të ballafaqohen me ato të mbrojtjes<sup>62</sup>.

<sup>60</sup> Në nenet 69 (1) dhe (2) të dy janë të barabartë dënimi nuk mund të rritet ose të zbutet. Përndryshe ai mund ose të rritet ose të zbutet.

<sup>61</sup> Neni 452 (2) nga Kodi i Procedurës Penale 1988.

<sup>62</sup> Neni 440 nga Kodi i Procedurës Penale 1988.

Në procedurën “pateggiamento”, gjykatësi duhet në mënyrë të pavarur të vlerësoj fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, në “abbreviato” kjo bëhet në bazë të përmbajtjes së dosjes së hetimit. Pas shqyrtimit të sodjes, dhe çfarëdo prove tjetër të parashtruar, gjykatësi ose mund të lirojë të pandehurin, or të shapllë atë fajtor dhe të imponojë zvogëlim të dënimit për një të tretën<sup>63</sup>. Zvogëlimi i dënimit për një të tretën kërkohet me kushtetutë në këmbim të parashtrim para “abbreviato.” Secila palë mund të ankohet ndaj dënimit. Kjo procedurë është në disponim për çfarëdo krimi, pavarësisht nga serioziteti. Për raste të dënimit të përjetshëm, dënimi mund të zvogëlohet në 30 vjet<sup>64</sup>. Llogaritet se rreth 10 % e rasteve të pashqyrtuara trajtohen në këtë mënyrë.

Kodi i vitit 1988 ishte i dizajnuar për të fuqizuar seancën kundërshtuese dhe për të eliminuar dosjen e hetuesisë nga dhoma e seancës gjyqësore. Kjo procedurë, megjithatë, ka efektin e kundërt, meqë i pandehuri mund të zgjedhë një gjykim me shkrim në kthim për zvogëlim të dënimit për një të tretën.

Në sistemet e ligjit zakonor në seancën e dëgjimit të dënimit i cili vjen pas deklaramentit të fajësisë gjykatësi penal ose ai për kundërvajtje mund të furnizohet me dokumentacion të ngjashëm – një informacion të plotë të dëshmimeve ose një përmbledhje të fakteve ose një përzierje e të dyjave. Dallimi është se në sistemet e ligjit zakonor procesi është akoma kundërshtues për atë se secila palë mund të prezantojë dëshmi, siç është thirrja e dëshmitarëve, edhe pse kjo nuk është e zakonshme në çështjet përmbledhëse të dëguara në gjykatën për kundërvajtje ose në atë më të ulët për kundërvajtje të vogla.

### 3.4. *Decreto penale di condanna* “ndjekje penale sipas dekretit për gjykim”

Mundësia e tretë është *decreto penale di condanna* “ndjekja penale sipas dekretit për gjykim”. Prokurori mund të kërkojë nga “gip” dhe pa pëlqimin e të pandehurit, që të vendos rastin në zyrën private të gjykatësit, në bazë të materialit në regjistrin e hetimit. Mbrojtja mund të mos flasë por mund të shfaqë dëshmi.

Kjo procedurë aplikohet për kundërvajtje të vogla të klasifikuara si keqbërje, që tërheqin ose gjobë ose dënim me burg i cili mund të zëvendësohet me gjobë. Përdoret në përpjekjet për zvogëlimin e ngarkimit të rasteve për prokurorët dhe gjykatat.

<sup>63</sup> Neni 438 (5) nga Kodi i Procedurës Penale 1988.

<sup>64</sup> Neni 442 (2) nga Kodi i Procedurës Penale 1988.



Gjykatësi mund të zvogëlojë dënimin deri në gjysmë, por vetëm të shqiptojë gjobë. Gjykatësi ka diskrecion të plotë në shqiptimin e dënimit të duhur. Mbrojtja mund të kontestojë vendimin brenda pesëmbëdhjetë ditëve dhe të zgjedhë gjykimin përmbledhës ose të kërkojë marrëveshje për deklarim të fajësisë.

### 3.5. Vlerësim se si kjo funksionon në praktikë

Sistemi italian i marrëveshjes për deklarim dallon shumë nga, fjala vjen, ai amerikan. Prandaj, prokurori ka më shumë gjasa të japë ofertën më lehtësuese mjaft para se të përfundojnë përgatitjet e gjyimit.

Për dallim, në Itali, i pandehuri mund të bie në ujdi, madje edhe me gjykatësin, pa pajtimin ose pjesëmarrjen e prokurorit në ditën e gjyimit<sup>65</sup>. Kjo në praktikë do të thotë se nuk ekzistojnë stimulime që të pandehurit të vendosin për rastet, dhe në veçanti nëse ato janë liruar me kaucion. Avokati mbrojtës nuk ka stimulim për të zgjidhur rastin para se të fillojë gjykimi, përveç nëse ata janë të emëruar për në gjykatë. Italia nuk ka zyrë të mbrojtësit publik. Vetëm kur të pandehurit kapen në vepër dhe kur ballafaqohen me një dënim të caktuar, atëherë ekziston stimulim i vërtetë për marrëveshje për të marrë zvogëlim të një të tretës.<sup>66</sup>

Shpjegim i arsyeshëm i prezantimit të këtyre procedurave ishte shpjeguar se është për të bërë sistemin e të drejtës penale më efikas dhe të ndihmojë në eliminimin e shtyrjeve në kohë të sjelljes së rasteve në gjykatë, gjë që shqetësonte shumë sistemin italian. Megjithatë, këto procedura janë shfrytëzuar vetëm në një të tretën e rasteve që do të thotë se ndikimi nuk ka qenë dramatik<sup>67</sup>.

<sup>65</sup> Neni 446 nga Kodi i Procedurës Penale 1988.

<sup>66</sup> Kritika e reformave italiane në praktikë në Marco Fabri, *Reformat e procedurës dhe të ndjekjes penale në Itali: një kthim mbrapa*, Punim i Konzorciumit Evropian për Hulumtim Politik, Pisa shtator 2007.

<sup>67</sup> Shih Giulio Illuminati dhe Michele Caianello "Faza hetimore e procesit penal në Itali" në Ed Cape, Jacqueline Hodgson, Ties Prakken dhe Taru Spronken, (botimet) *Të dyshuarit në Evropë: të drejtat procedurale në fazën e hetimit të një procesi penal në Unionin Evropian*, Intersentia 2009, faqe 133.

## 4. BOSNJA E HERCEGOVINA

### 4.1. Hyrje

Para prezantimit të Kodit për Procedurë Penale të vitit 2003, Bosnja e Hercegovina, si edhe shtetet tjera të ish Jugosllavisë përdorte një procedurë të pastër të së drejtës civile për zgjidhjen e rasteve kriminale në gjykatë.

Propozim kodi penal ishte i përpiluar nga grup punues i ekspertëve ligjorë nga Bosnja e Hercegovina. Një raport i OSBE-së e përshkruan sistemin e ri si një 'hibrid', 'kundërshtues' ose 'përzierje'<sup>68</sup>.

Kodi prezantoi konceptet e deklarimit të fajësisë dhe të marrëveshjes për deklarim të fajësisë. Edhe pse u shfrytëzua me sukses në gjykatat e tjera dhe në departamentet e gjykatës për krime ekonomike dhe të organizuara, marrëveshja e parë për deklarim nuk erdhi në dhomën e Gjykatës së Bosnje e Hercegovinës për krime luftime para muajit shkurt të vitit 2008.

Me vendosjen e kodit në nivel nacional dhe të etnitetit, përfaqësuesi i lartë shpjegoi nevojën për një kod të procedurës penale në nivel shtetëror, i cili ishte "në përputhje me standardet e pranuar moderne ndërkombëtare në fushën e procedurës penale dhe e cila do të përputhej me garancitë e parapara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut"<sup>69</sup>.

Disa arsye për prezantimin e metodave kundërshtuese të gjykimit në sistem civil në një sistem ligjor të pas konfliktit përfshinte dëshirën për të pasur një prokuror të pavarur, i cili do të sillte vendime publike, dhe përsheptim të procesit gjyqësor me futjen në fuqi të limiteve kohore rigoroze për aktakuzën, fillimin e gjykimit, dëgjimin për depozitim dhe apelimet.

### 4.2. Deklarimi i fajësisë

Kodi i Procedurës Penale i vitit 2003 prezantoi konceptin e deklarimit të fajësisë në sistemin ligjor të Bosnjës. Me nenin 229, një i akuzuar duhet të deklarohet fajtor ose i pafajshëm për një aktakuzë gjatë dëgjimit preliminar. Nëse dështon deklarimi i fajësisë gjykatësi hyn në deklarim si jo fajtor nga

<sup>68</sup> Raporti i OSBE-së nga Vëzhgimi i gjykimit në implementimin e Kodit të Ri për Procedurë Penale në Gjykatat e BeH, dhjetor 2004, faqe 1.

<sup>69</sup> Vendimi i Përfaqësuesit të Lartë – nr 3/2003.

pozita *ex officio*. Para se të hyjë në këtë deklaram i akuzuari duhet, patjetër, të këshillohet për pasojat që dalin nga vendimi i tij, që do të thotë se:

deklarimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, me vetëdije dhe me mirëkuptim; i akuzuari ka qenë i informuar dhe e ka kuptuar refuzimin e të drejtës për gjykim'

se ekzistojnë mjaft dëshmi për fajësinë e të akzuarit;

i akuzuari ishte i informuar dhe ka kuptuar pasojat e mundshme në lidhje me kërkesën e mundshme për pronë dhe konfiskimin e mundur; dhe ligji dhe konfiskimi i pronës së fituar janë mundësuar nga provizionet prej kundërvajtjes kriminale dhe pagesa të mundshme.

Gjykata duhet të jetë e kënaqur nga të gjitha këto të numëruarat dhe mund të refuzojë deklaramin<sup>70</sup>.

### 4.3. Marrëveshja statusore e deklaramit

Neni 231 i Kodit për Procedurë Penale me titull “marrëveshja për deklaram” rregullon procedurën. Një i dyshuar apo i akzuar dhe avokati mbrojtës mund të negociojnë me Prokurorin për kushtet lidhur me pranimin e fajësisë për kundërvajtjen penale me të cilën i dyshuari ose i akuzuari është i ngarkuar. Ata mund ta bëjnë këtë para përfundimit të gjykimit kryesor ose të seancës në gjykatën e apelit, por nuk mund të bëjnë pas dhënies së deklaramit të fajësisë.

Prokurori mund të sugjerojë dënim më të vogël se ai obligues<sup>71</sup> – siç është për shembull zvogëlimi i burgimit “afatgjatë” që zakonisht është 20 vjet, deri në minimum 5 vjet. Në kuptimin kushtetues rregulli i tillë duket se parashikon marrëveshjen për akuzim. Për shembull, palët mund të negociojnë për të akzuarin që të paditet për një kundërvajtje më të lehtë se ajo që është nën hetime, për shembull një aktakuzë e cila bëhet për krime kundër njerëzimit në vend të asaj për gjenocidit.

Praktika tregon se palët duhet t'i qasen Gjykatës me një marrëveshje të shkruar për deklaram duke vendosur kështu baza faktike për deklaramin dhe për marrëveshjen lidhur me faktet.

<sup>70</sup> Neni 230 (3) nga Kodi i Procedurës Penale 2003

<sup>71</sup> Neni 231 nga Kodi i Procedurës Penale 2003.

Gjykata mund të refuzojë ose të pranojë marrëveshjen dhe duhet patjetër të mendojë për marrëveshjen e deklaramit të fajit dhe në të njëjtën mënyrë mendon, nëse pranohet deklarimi i fajësisë.<sup>72</sup>

Gjykata duket se nuk ka kurrfarë diskrecioni dhe se obligohet me dënimin e sugjeruar. Neni 231 (7) siguron, “Në rast se Gjykata pranon marrëveshjen për deklaram, atëherë deklarata e të akuzuarit do të futet në regjistër dhe Gjykata do të vazhdojë me dëgjimin për shpalljen e dënimit të paraprirë me marrëveshje”. Në rast se gjykata e refuzon atë, rasti dërgohet për gjykim brenda 30 ditëve.

Me deklaram të fajësisë i pandehuri heqë dorë nga e drejta për apelim të dënimit që vendoset sipas marrëveshjes për deklaram<sup>73</sup>. Megjithatë, Gjykata, duket se mund të vendosë një dënim më të lartë se ai i parashikuari me marrëveshjen për deklaram, dhe kështu të akuzuarit i jep të drejtën për apelim kundër dënimit.

Gjithashtu kërkohet nga gjykata të informojë çdo palë të dëmtuar për rezultatet e marrëveshjes për deklaram. Kodi nuk mundëson pjesëmarrjen e viktimeve apo të palëve të dëmtuara në procesin e marrëveshjes për deklaram. Megjithatë, pasoja e deklaramit është në plotësimin e kërkesave pronësore të bëra nga viktimat kundër të pandehurit.

#### 4.4. Marrëveshja për deklaram të fajit në praktikë

Një raport i OSBE-së i vitit 2006 analizoi përdorimin marrëveshjes për deklaram të fajit nëpër gjykata të ndryshme të Bosnjë e Hercegovinës. Në të thuhet se gjyqësia ka përvetësuar marrëveshjet për deklaram të fajit duke vërtetuar “përdorimin e tyre në të gjitha rastet e ndryshme, nga më të voglat për kundërvajtje të hyrjes pa leje e deri te rastet e krimeve kundër njerëzimit”<sup>74</sup>.

Raporti konkludoi se “Marrëveshjet për deklaram më së shpeshti negociohen pas dëgjimit gjyqësor të deklaramit, por para gjykimit kryesor – ky ishte rast në 77% të deklarimeve të vëzhguara”<sup>75</sup>.

Për arsye se legjislacioni nuk lejon diskrecion në lidhje me dënimin (në përputhje me marrëveshjen për deklaram) në ç`rast është zhvilluar një praktikë

<sup>72</sup> Neni 231 (6) nga Kodi i Procedurës Penale 2003.

<sup>73</sup> Neni 231 (4) (c) nga Kodi i Procedurës Penale 2003.

<sup>74</sup> Raporti i OSBE për marrëveshjet e deklaramit të fajësisë, faqe 2, 8.

kur palët i sugjerojnë Gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, një shkallë të dënimit, duke i dhënë kështu pranimit të marrëveshjes një shans më të madhe për sukses. Për shembull, palët mund të sugjerojnë një shkallë dënimi mes 5 dhe 10 vjetëve për një kundërvajtje e cila mundet, përndryshe, të sanksionohet me një dënim prej 20 vjetëve.

Skema legislative duket se nuk ka parashikuar marrëveshje për akuzë, prandaj edhe duket se kufizohet në marrëveshje për dënim. Megjithatë, marrëveshja për akuzë nuk përjashtohet në mënyrë të veçantë dhe ajo është shfrytëzuar<sup>76</sup>.

Vlerësimi paraprak i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë ka qenë pozitiv lidhur me pranimin nga ana e gjykatave të marrëveshjes për deklaram të fajit. Po përdoret me të madhe neni 231 dhe ekuivalentët e tij për të gjitha krimet, ndërsa përdorimi i tij pranë Gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës po rritet në rastet e krimeve të luftës.

Tre rastet e përfunduara për krime lufte ilustrojnë se si kjo ka funksionuar në praktikë:

- **Ljubisha Çetiq** (Masakra në Koriqanske Stijene). I pandehuri dhe shtatë të tjerë ishin të akuzuar për pjesëmarrje në vrasje masive që ishte objekt i rastit të *Darko Mrgjës* në TNKJ të përshkruar më poshtë. Ai e ndërroi deklaramin e vet fillestar nga i pafajshëm në fajtor për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit. Marrëveshja për deklaram të fajit propozonte një dënim mes 11 dhe 13 vjet. Gjykata e pranoi marrëveshjen dhe e dënoi atë me 13 vjet burgim<sup>77</sup>.
- I bashkakuzuari i Çetiq-it, **Gordan Gjuriq-i**, u deklarua i pafajshëm dhe shkoi në gjykim. Në mes të gjykimit ai hyri në marrëveshje për deklaram të fajit me të cilën ai u pajtua të dëshmojë kundër të tjerëve dhe të pranojë fajësinë e vet. Ai dha dëshmi por disa nga dëshmitë e tij nuk ishin në pajtim me pretendimet në aktakuzën kundër tij. Gjykata refuzoi marrëveshjen për deklaram të fajit dhe e bashkëngjiti rastin e tij me të bashkakuzuarit e tjerë. Pas gjashtë javëve ai u fut në marrëveshjen e dytë për deklaram të fajit dhe përsëri dëshmoi, këtë radhë në pajtim me pretendimet e deklaruara.

<sup>75</sup> Raporti i OSBE për marrëveshjet e deklaramit, faqe 12.

<sup>76</sup> Shih, për shembull *Zyra e Prokurorëve të BeH kundër Vaso Todoroviqit X-KR-06/180-1*, vendimi gjyqësor i shkallës së parë, 2 tetor 2008, prokuroria e ndryshoi aktakuzën fillestare për të zvogëluar akuzat e gjenocidit në llogari të krimeve kundër njerëzimit. I pandehuri deklaroi fajësinë dhe u pajtua të ndihmojë hetimet dhe gjykimet tjera sipas nevojës.

<sup>77</sup> *Zyra e Prokurorëve të BeH-së kundër Ljubisha Çetiqit X-KR-08/549-3*, Vendimi gjyqësor i shkallës së parë 18 mars 2010.

Marrëveshja sugjeronte dënim ndërmjet 7 dhe 10 vjetëve burgim. Pastaj gjykata e pranoi marrëveshjen për deklaram dhe e dënoi atë me 8 vjet burgim në bazë të asaj se ai ka mbajtur rojë dhe nuk ka shtirë personalisht kundër të burgosurve<sup>78</sup>.

- **Pashko Lubiçiq**, një komandant ushtarak në Këshillin kroat të mbrojtjes u padit nga Tribunali Ndërkombëtar i Krimeve në ish-Jugosllavi (TNKJ) për pjesëmarrjen e tij në sulmin ndaj fshatit Ahmiçi që rezultoi me vdekjen e më shumë se 100 civilëve dhe shkatërrimin e shtëpive dhe xhamive. Rasti i tij u transferua në Gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ai arriti të bëjë një marrëveshje për deklaram në bazë të së cilës prokuroria ndryshoi akuzat prej krimeve kundër njerëzimit në krime lufte kundër popullatës civile (sulme dhe shkatërrim të papërmbajtur të pronës). Marrëveshja saktëson se ai duhej të shpaloste para Zyrës së Prokurorëve të BeH-së dhe të TNKJ-së çdo gjë që ai kishte dijeni për disa sulme të caktuara ushtarake. Prokuroria dorëzoi se një dënim prej 9 vjet është adekuat, ndërsa mbrojtja sugjeroi 8 vjet. Gjykata pranoi marrëveshjen për deklaram të fajit dhe e dënoi të pandehurin me 10 vjet burgim. Gjykata vërtetoi se pranimi i tij i fajësisë dhe pendimi i tij i sigurtë mund të ketë ndikim pozitiv në rehabilitimin e viktimave dhe në pranimin e fakteve<sup>79</sup>.
- **Muadin Emrulai** u deklarua i fajshëm sipas marrëveshjes për pranim të fajit për pjesëmarrjen në organizimin e kontrabandimit të njerëzve, duke u dakorduar në dënim deri në dy vjet burgim me kusht që të mos kryej asnjë vepër penale brenda tri viteve. I pandehuri ka pranuar se ka marrë pjesë në lëvizjen ilegale të njerëzve përtej kufirit të Bosnjë dhe Hercegovinës për në Kroaci dhe Mal të Zi për pagesë me vlerë prej 50-1000 Euro. Gjykata pranoi marrëveshjen dhe e dënoi atë në një vit dhe nëntë muaj burgim<sup>80</sup>.
- **Sead Adiloviç** u deklarua i fajshëm sipas marrëveshjes për pranim të fajit për përdorimin me dije të bankënotës së falsifikuar prej 100 KM (50 euro) për blerjen e ilaçeve me vlerë prej 15 KM. Marrëveshja theksonte se ai mund të dënohej me burgim prej një deri tre muaj dhe gjykata pranoi marrëveshjen dhe e dënoi me dy muaj burgim, duke pasur parasysh gjendjen e familjes së tij dhe se kishte kryer kundërvajtje për herë të parë.<sup>81</sup>

<sup>78</sup> Zyra e Prokurorëve të BeH-së kundër Gordan Gjuriçiq X-KR-08/549-2, Vendimi gjyqësor i shkallës së parë, 10 shtator 2009.

<sup>79</sup> Zyra e Prokurorëve të BeH-së kundër Pashko Lubiçiqit X-KR-06/241, Vendimi gjyqësor i shkallës së parë, 29 prill 2008.

<sup>80</sup> Zyra e Prokurorëve të BeH-së kundër Muadin Emrulai X-K-08/635, Vendimi gjyqësor i shkallës së parë, 22 janar 2009.

<sup>81</sup> Zyra e Prokurorëve të BeH-së kundër Sead Adiloviç X-K-07/474-8, Vendimi gjyqësor i shkallës së parë, 29 gusht 2009.

## 5. GJYKATAT DHE TRIBUNALËT NDËRKOMBËTARË

### 5.1. Hyrje

Tribunalët ndërkombëtarë ad hoc dhe hibrid, TNKJ, Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ruandë (TNKR), Tribunali Special për Libanin (TSL), Gjykata Speciale për the Siera Leone (GjSSL) (me përjashtim të Dhomës së Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias (DhJGjK)), të gjitha mundësojnë ujdi ose marrëveshje për deklaram. Të gjitha këto tribunalë shfrytëzojnë metodë të gjykimit kundërshtues. Statuti dhe Rregullorja e Gjykatës Ndërkombëtare për Krime (GjNK) nuk e përmendin me saktësi termin “marrëveshje për deklaram të fajit”, mirëpo, si duket, nuk parandalojnë marrëveshjet për deklaram.

TNKJ, TNKR, GjSSL dhe TSL përdorin konceptin e ligjit zakonor ose kundërshtues të deklaramit të fajësisë. I akuzuari së pari duhet të deklarojë se është fajtor para se të dënohet.

Statuti i TNKJ-së prezantoi konceptin e deklaramit të fajësisë në të drejtën penale ndërkombëtare. Gjykatësi Cassese vërejti se sistemi i deklaramit të fajësisë ose i pafajësisë ishte i nxjerrë nga sistemet e ligjit zakonor, duke vërejtur se “kjo praktikë nuk kishte shembull të drejtpërdrejtë në traditën e të drejtës civile ku një pranim i fajësisë është, thjeshtë, një pjesë e dëshmimeve që duhet të merren në konsideratë dhe të vlerësohen nga ana e gjykatës”. Ai vërejti se shpjegim i arsyeshëm për këtë qasje duket se ishte “t’i mundësohet të akuzuarit (po edhe Prokurorit) t’i shmanget një gjykimi i gjatë me të gjitha vështirësitë e veta... të gjitha të rëndësishme për në seancat ndërkombëtare”. Këto përfshijnë aktivitet “tejet të lodhshëm që merr kohë” të grumbullimit të dëshmimeve, mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve, kostoja e seancave ishte e madhe për shkak të përkthimeve me shkrim e me gojë, transportit ndërkombëtar i viktimave dhe dëshmitarëve si dhe asistencës së tyre për në gjykim. Deklarami i fajësisë është në favor të publikut, ai mund të jetë i dobishëm edhe për të akuzuarin duke e kursyer atë nga paraqitja në gjykim dhe të ekspozimit në publik. Plus kësaj të akuzuarit i mundësohet të shlyej fajin dhe të merr një dënim të zvogëluar<sup>82</sup>.

Ky mendim ishte shkruar para se Rregullorja e TNKJ-së të aprovonte konceptin e “marrëveshjes për deklaram” me një amendament në Rregulloren, që i shtohet rregullës 62 ter dhe duke kodifikuar procedurën. Raporti i parë vjetor i TNKJ-së

<sup>82</sup> Prokurori kundër Drazhen Erdomoviç -92-22-A, 22 tetor 1997, “Opinion i ndarë dhe i kundërt i gjykatësit Cassese”, në paragrafët 7-8.

në vitin 1994 madje me saktësi shënon se “praktika e marrëveshjes për deklarim nuk gjendet në rregullore”, madje jo para dhjetorit të vitit 2001. Gjykatësit arritën të aprovojnë zyrtarisht rregullat për marrëveshje për deklarim. Teksti i Rregullës 62 *ter* kryesisht buron nga Rregullat Federale të Procedurës Penale të Shteteve të Bashkuara.

Një nga dallimet kryesore në deklarimet e fajësisë në mes të drejtësisë ndërkombëtare dhe sistemeve vendore të cilët përdorin deklarimin e fajësisë qëndron në përdorimin e tij. Në juridiksionet e ligjit zakonor deklarimet e fajësisë zakonisht ndodhin, gati, në të gjitha rastet e sjella në gjykatë. Në të drejtën penale ndërkombëtare në marrëveshje të fajësisë hyn një përqindje shumë e vogël e të pandehurve (në TNKJ deri më sot 20 prej 161 të akuzuarve janë deklaruar të jenë fajtorë).

Veçanërisht, në TSL, në tribunalin më të ri hibrid ndërkombëtar, i cili shfrytëzon një përzierje ligjesh penale ndërkombëtare dhe atyreve Libaneze ka miratuar një procedurë të ngjashme<sup>83</sup>.

## 5.2. TNKJ

TNKJ ka një procedurë për marrëveshje deklarimi të rregulluar me rregullore. Brenda 30 ditëve nga paraqitja e parë pas arrestimit, i akuzuari duhet të hyjë në deklarim të fajësisë apo të pafajësisë<sup>84</sup>. Para se të pranojë deklarimin, Dhoma gjyqësore duhet të jetë e bindur se deklarimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, në bazë të informimit, i qartë, dhe me bazë të mjaftueshme faktike për krimin dhe për pjesëmarrjen e të akuzuarit në të<sup>85</sup>.

Rregulla 62 *ter* siguron procedurë për marrëveshje deklarimi. Kjo i mundëson Prokurorit dhe mbrojtjes të pajtohen se në bazë të pranimit të marrëveshjes për deklarim nga ana e të akuzuarit, Prokurori mund të aplikojë ndryshimin e aktakuzës dhe të dorëzojë kërkesë për një dënim ose shkallë dënimi të caktuar. Dhoma gjyqësore nuk obligohet nga asnjë marrëveshje. Ajo ka dënuar tre të akuzuar me kushte

<sup>83</sup> Shih rregullat 99 dhe 100 në Rregullat e procedurës dhe të dëshmive të TNKJ-së.

<sup>84</sup> Rregulla 62 (IV) nga Rregullat e procedurës dhe të dëshmive.

<sup>85</sup> Rregulla 62 *bis* Rregullat e procedurës dhe të dëshmive.

<sup>86</sup> *Prokurori kundër Momir Nikoliqit -02-60/1-2*; Vendimi i dënimit, 2 dhjetor 2002 (marrëveshja saktësonte 15 deri 20 vjet, dënimi ishte 23 vjet); *Prokurori kundër Dragan Nikoliqit -94-2-S*, Vendimi i dënimit, 18 dhjetor 2003 (marrëveshja ishte 15, ndërsa dënimi 27 vjet); *Prokurori kundër Milan Babiqit -03-72-S*, Vendimi i dënimit, 29 qershor 2004 (marrëveshja saktësonte 11 vjet, dënimi ishte 13 vjet).



burgimi më të larta në krahasim me ato të siguruara me marrëveshjen për deklaram<sup>86</sup>. Kjo parasheh marrëveshje edhe për akuzën edhe për dënimin. Ligji i Tribunalit këtë e arsyeton me kërkesën se para pranimit të deklaramit të fajësisë Dhoma duhet të jetë e sigurt se i akuzuari në aspekt psikik është i aftë, se e kupton natyrën e akuzave dhe pasojat e deklaramit, se nuk ka qenë i kërcënuar ose i joshur gabimisht për të pranuar fajësinë, se deklarami i tij ka bazë faktike të mjaftueshme juridike dhe se deklarami i fajit pasqyron në tërësi veprën penale.

Marrëveshjet për deklaram të fajit duhet të jenë të shkruara dhe të zbardhura para gjykatës në mënyrë publike. Negocimet për deklaram përfshijnë vetëm prokurorinë dhe mbrojtjen, por jo edhe gjykatësit. Prokuroria mund të dorëzojë ndryshime të aktakuzës me të cilat ofron akuza për të cilat i akuzuari do të deklarohej i fajshëm sipas marrëveshjes për deklaram të fajit.

Nuk ekzistojnë procedura apo praktika të caktuara. Prokuroria nuk e ka medoemos të ndryshojë aktakuzën. I akuzuari nuk e ka medoemos të ofrojë asistencë për prokurorinë. Gjatë dëgjimit të dënimit palët mund të kërkojnë dëshmitë. Për shembull, prokuroria mund të kërkojë dëshmitë e viktimës ose të ekspertit, mbrojtja mund të thërret dëshmitë e të akuzuarit ose të individit, ndërsa Dhoma gjyqësore mund të kërkojë dëshminë e ekspertit të vet.

Ndryshe nga, të themi Bosnja e Hercegovina, nuk ka heqje dorë ligjore nga e drejta për të kundërshtuar dënimin e shqiptuar sipas marrëveshjes për deklaram të fajit. Prokuroria mund të negociojë një heqje dorë të këtillë si pjesë të marrëveshjes për të saktësuar se i akuzuari nuk do të kundërshtojë dënimin nëse ai shqiptohet brenda shkallës së saktësuar në te<sup>87</sup>.

Deri më sot, 20 të akuzuar kanë hyrë në marrëveshje për deklaram të fajit me prokurorinë. Për të ilustruar se si TNKJ-ja merret me marrëveshjet për deklaram tregojnë tre shembujt në vijim,

- Rasti i **Darko Mërgjës** i përket vrasjes të më shumë se dyqind meshkujve mysliman afër vendit Koriqanske Stijene, pranë malit Vlashi në Bosnjë e Hercegovinë në gusht të vitit 1992. Rreth 1200 civilë kroatë dhe mysliman të Bosnjës u morën me autobusë nga kampet e burgimit pasi që iu kishin thënë se do t'i dërgonin për këmbim. Më shumë se 200 meshkuj u zbritën prej autobusëve dhe me autobusë tjerë u dërguan në një luginë ku ata u vranë duke shtirë në ta në cep të një shkëmbi. Mërgja, një oficer policie, i

<sup>87</sup> Për shembull, në *Prokurori kundër Stevan Todoroviçit* -95-9/1 Vendimi i dënimit, 31 korrik 2001; *Prokurori kundër Milan Simiqit* -95-9/2 Vendimi i dënimit, 17 tetor 2002.

cili kishte marrë pjesë në vrasjet, ishte akuzuar për asgjësim si krim kundër njerëzimit, për vrasje si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës dhe për vepra jonjerëzore dhe krime kundër njerëzimit. Ai hyri në një marrëveshje me shkrim për deklarim të fajit me prokurorinë dhe, në bazë të kësaj, ai u deklarua se pranon fajësinë për dy prej tre akuzave. Ai pranoi pjesëmarrjen e tij në masakër. Në seancën e shqyrtimit të dënimit dëshmitë e veta i dhanë i akuzuari, një i mbijetuar nga masakra dhe përfaqësuesi i shoqatës të viktimave. Marrëveshja për deklarim të fajit obligonte Mërgjën që të bashkëpunoj me prokurorinë, dhe prokurori u pajtua se ai kishte siguruar bashkëpunim të dukshëm (në një shtojcë të futur në skedar të sekret). Dhoma gjyqësore pranoi se bashkëpunimi dhe deklarimi i fajësisë janë rrethana lehtësuese dhe se deklarimi ka ndihmuar që të përcaktohet e vërteta për krimin dhe me këtë mund të inkurajohet pajtimi. Prokuroria rekomandoi një dënim mes 15 dhe 20 vjetësh, ndërsa mbrojtja rekomandoi dënim prej 15 vjet. Dhoma gjyqësore vendosi dënim prej 17 vjet burgim. Dënimi nuk u kundërshtua<sup>88</sup>. Ndjekje tjera penale u paraqitën në Gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës në lidhje me të njëjtin krim.

- **Biljana Plavshiq** gjatë konfliktit ishte anëtare e Presidencës së Republikës Serbe në Bosnje e Hercegovinë. Ajo ishte e akuzuar së bashku me Radovan Karaxhiqin për, pjesëmarrje në gjenocid dhe persekutim, shfarosje dhe vrasje, depërtim dhe akte johumane si krime kundër njerëzimit. Ajo nënshkroi marrëveshje për deklarim të fajit me prokurorinë, pjesë e së cilës ishin pesë faqe të bazës faktike të deklarimit. Ajo hyri në deklarim të fajësisë për akuzën e persekutimit dhe Dhoma gjyqësore i lejoi prokurorisë të tërheqin akuzat tjera. Bazat faktike të shkruara të deklarimit të saj pranonin se, mes tjerash, janë ftuar dhe inkurajuar paramilitarët nga Serbia të asistojnë forcat Serbe të Bosnjës, të ndikojnë në ndarjen etnike me forcë dhe të mbështesin persekutimin përmes pjesëmarrjes së saj në strukturat udhëheqëse. Aktakuza numëronte 37 komuna në Bosnjë e Hercegovinë në të cilat ndodhën persekutimet. Prokurori paraqiti se në mungesë të deklarimit një dënim me burgim të përjetshëm do të ishte adekuat. Atë kohë ajo ishte në moshë 72 vjeçe. Prokuroria kërkoi një dënim mes 15 dhe 25 vjet ndërsa mbrojtja paraqitën se dënimi me 8 vjet heqje lirie do të ishte adekuat.

Dhoma gjyqësore konkludoi se deklarimi i saj për fajësi, dorëzimi i saj vullnetar në Tribunal, mosha dhe sjellja e saj pas konfliktit ishin të gjitha

<sup>88</sup> Prokurori kundër Darko Mrgjës -02-59-S Vendimi i dënimit 31 mars 2004.

<sup>89</sup> Prokurori kundër Biljana Plavshiqit -00-39&40/1-S, Vendimi i dënimit, 27 shkurt 2003.

rrethana lehtësuese dhe e dënuan atë me 11 vjet burg. Asnjëra palë nuk e kundërshtoi dënimin<sup>89</sup>.

- Shembull tjetër është rasti i **Dragan Nikoliqit**, komandantit të qendrës për burgim afër Vlasenicës në Bosnjë e Hercegovinë në të cilën qindra civilë myslimanë dhe jo-serbë ishin të burgosur në kushte johumane për jetesë. Ndodhën vrasje, dhunime dhe tortura. Ai u akuzua për persekutim si krim kundër njerëzimit. Disa vjet pas paraburgimit të tij, mu në ditën e fillimit të një seance dëgjimi të depozitimeve, ai arriti të bëjë marrëveshje për deklarim të fajit me prokurorinë në të cilën u pajtua me pretendimet e aktakuzës (si bazë faktike e deklarimit). Ai, po ashtu, i dha një asistencë prokurorisë. Prokuroria rekomandoi një dënim prej 15 vjet heqje lirie. Mbrojtja u pajtua me këtë. Dhoma gjyqësore, megjithatë, nuk e pranoi këtë dhe e dënoi me 23 vjet burg, duke vlerësuar se një dënim prej 15 vjetësh nuk do të ishte i drejtë.<sup>90</sup> Nikoliqi e kundërshtoi dënimin. Dhoma e Apelit e zvogëloi dënimin në 20 vjet në bazë të asaj se Dhoma gjyqësore kishte gabuar në përcaktimin e saktë të kohës që ai do duhej ta mbante para se të lirohej. Ajo nuk pranoi të shqyrtojë bazën e apelit se “Dhoma gjyqësore ka vendosur një pikënisje tepër të lartë për burgim”.<sup>91</sup>

### 5.3. Gjykata Ndërkombëtare për Krime

Statuti i GjNK-së nuk e preferon shprehjen “deklarim të fajësisë”, por më shumë si një “pranim të fajësisë”. Kjo rezultoi nga kompromiset e bëra mes delegacioneve të ligjit zakonor dhe të drejtës civile gjatë negociatave të vitit 1998.

Në fillim të gjykimit, i akuzuari mund të deklarohet jo fajtor ose “të bëjë një pranim të fajësisë”.<sup>92</sup>

Neni 65 rregullon seancën e pranimit të fajësisë. Nga Dhoma gjyqësore kërkohet të përcaktojë vallë i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit, akuzat dhe materialin e prezantuar që mbështesin pranimin. Ajo pastaj shqyrton vallë faktet kryesore janë të vendosura në mënyrë të nevojshme për të vërtetuar se krimi është kryer. Ajo mund të kërkon më shumë dëshmi ose të përcjellë rastin në gjykim. Neni 65 (5) parasheh se çdo diskutim mes Prokurorit dhe mbrojtjes në lidhje me “modifikimin e akuzave, pranimin e fajësisë ose të dënimit që duhet të shqyrtohet, nuk duhet të jetë obligues

<sup>90</sup> Prokurori kundër Dragan Nikoliqit -94-2-S, Vendimi i dënimit, 18 dhjetor 2003

<sup>91</sup> Prokurori kundër Dragan Nikoliqit 94-2-A, Vendim për Apelin kundër dënimit, 4 shkurt 2005.

<sup>92</sup> Neni 65 (8) (a) Statuti i GjNK-së.

për Gjykatën”. Sipas rregullës 139, Gjykata pastaj merr vendimin e vet në lidhje me pranimin e fajësisë.

Gjykata duhet, patjetër, të konfirmojë se i pandehuri ka marrë “konsultime të mjaftueshme nga avokati” para se të pranojë një pranim të fajësisë<sup>93</sup>.

Nëse refuzon marrëveshjen ajo duhet të japë arsyet. Gjykata mund të refuzojë pranimin e fajësisë dhe të përcjellë rastin në gjykim<sup>94</sup>. Gjykata mund të miratojë pranimin e fajësisë, por edhe të kërkojë prokuroria të prezantojë dëshmi shtesë në rast se beson “se një prezantim më i plotë i fakteve të rastit do të ishte i nevojshëm në interes të drejtësisë, e në veçanti në interes të viktimave” Neni 65 (4). Statuti dhe Rregullorja e GjNK-së nuk parashohin saktësisht se një pranim i fajësisë është rrethanë lehtësuese për dënimin, por bashkëpunimin me Gjykatën e konsiderojnë si rrethanë lehtësuese.

Marrëveshja për deklaram të fajit, edhe pse nuk është e paraparë në mënyrë të qartë, prapëseprapë nuk është e ndaluar dhe duket se është e paraparë me Rregullore. Gjykata deri më sot nuk ka asnjë shembull të pranimin të fajësisë.

#### 5.4. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Praktika e dënimit është e rregulluar nga ana e gjykatave nacionale dhe në pak raste drejtpërdrejt të lidhura me marrëveshjen për pranim të fajit kanë arritur deri në Gjykatën Evropiane.

Një fushë e ligjit për të drejtat e njeriut është heqja dorë nga neni 6 -e drejta për gjykim të drejtë e cila nënkupton dakordimin për procedurë të ngjashme me atë të sistemit italian “abbreviato”.

Gjykata Evropiane ka konsideruar këtë çështje në mënyrë direkte. Ajo ka njohur përparësitë e të pandehurit, nëse dënohet, lidhur me zvogëlimin e dukshëm të dënimit dhe pamundësinë e prokurorisë të kundërshtojë dënimin e cila nuk ndryshon karakteristikën ligjore të kundërvajtjes. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, gjykata ka theksuar se kjo përbënte zvogëlim të mbrojtjes procedurale duke hequr dorë nga e drejta për seancë publike dhe sjelljen e provave të reja dhe thirrjen në gjyq të dëshmitarëve. Neni 6 i Konventës nuk parandalon personin të heq dorë nga këto të drejta të veçanta me dëshirë të

<sup>93</sup> Neni 65 (1) (b) Statuti i GjNK-së.

<sup>94</sup> Neni 65 (4) dhe Rregulla 139 nga Statuti dhe Rregullorja e Gjykatës ndërkombëtare për krime.

<sup>95</sup> Rasti i Scoppola kundër Italisë (nr.2), aplikimi 10249/03, 17 shtator 2009.

## 70

veten, por heqja dorë duhet të jetë e qartë. Kjo heqje dorë nga të drejtat nuk mund të luftohet me asnjë çështje të veprimit publik.<sup>95</sup>

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është parimi i së drejtës së barabartë ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes. Të drejtat e garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut fillojnë atëherë kur një person njoftohet për ngritjen e akuzës nga ana e prokurorit – pavarësisht se ajo është sjellë apo e konfirmuar në gjykatë<sup>96</sup>. Kjo ndikon në procesin e negocimit mes prokurorisë dhe mbrojtjes dhe parimit të së drejtës së barabartë në seancën gjyqësore.

Ky parim, obligon trajtim të barabartë për të gjithë personat që gjenden para gjyqit. Gjykata Evropiane e interpreton këtë në kuptimin se "...çdo pale duhet patjetër t'i mundësohet ta prezantojë rastin e vet në mënyrë të arsyeshme, përfshirë këtu edhe dëshmitë e veta, të cilat nuk e vënë atë në pozitë dukshëm të pafavorshme vis-à-vis kundërshtarit të vet...".<sup>97</sup>

Në negociatat për deklaram prokurori duket se ka së paku një përparësi fillestare. Në raportin e OSBE-së thuhet<sup>98</sup>.

"Në kontekst të negocimit për deklaram, ky princip ka implikacione për shkallën e ekzistimit të barazisë në fuqinë e negocimit mes prokurorit dhe të të dyshuarit apo të akuzuarit. Në praktikë, mënyra më e mirë për të barazuar pozitën e palëve, është që i akuzuari të ketë ndihmën e avokatit mbrojtës në procesin e negocimit. Më tej, me rrumbullakimin e marrëveshjeve të deklaramit, vetëm pas konfirmimit të aktakuzës, por para se të bëhet deklarami i fajësisë, gjithashtu bëhet barazimi i fuqisë të negocimit mes palëve."

I pandehuri mund të jetë në situatë të pafavorshme me hyrjen e tij në marrëveshje për deklaram para konfirmimit të aktakuzës ose të akuzave të dërguara në gjykatë. Kjo është kështu për arsye se në atë fazë i pandehuri mund të mos jetë i njoftuar me dëshmitë e prokurorisë dhe kështu nuk është në gjendje të marrë një vendim të bazuar në informim se si duhet të deklarohet për akuzat ndaj tij.

I pandehuri po ashtu mund të jetë në pozitë të pafavorshme duke hyrë në marrëveshje për deklaram, pa hapje nga ana e prokurorit, e cila është e nevojshme që t'i mundësojë atij ose asaj të marrë një vendim të bazuar në informacion dhe në këshillë të duhur juridike.

<sup>96</sup> Rasti *Deweere kundër Belgjikës*, A-35, 27 shkurt 1980, parag. 46

<sup>97</sup> *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, A-27, 27 tetor 1993 para. 33.

<sup>98</sup> Raporti i OSBE-së për marrëveshjet e deklaramit 2006, f. 10.

## MARRËVESHJA PËR PRANIM TË FAJIT - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 71

Po ashtu, ujdia për deklaram të fajësisë ose pranimi i fajësisë është thelbësore për heqje dorë nga e drejta për gjykim në seancë gjyqësore. Kjo, detyrimisht, duhet të jetë e vlefshme në mënyrë të qartë. Një person mund të heqë dorë nga e drejta për të dalë para gjykatës, por heqja dorë nuk mund të “njolloset me detyrim”<sup>99</sup>.

Prandaj, sipas ligjit për të drejta të njeriut, vetëdëshira është një çështje e rëndësishme për marrëveshjen për deklaram.

Gjykata Evropiane vlerëson se neni 6 nuk është shkelur në sistemet ku i akuzuari deklaron fajësinë e vet në fillim të ndjekjes penale dhe nuk mbahet kurrfarë dëgjimi gjyqësor për fajësi apo pafajësi, por vetëm se për të dhënë dënimin, po qe se ekzistojnë mbrojtjet adekuate për të parandaluar keqpërdorimin në veçanti në Mbretëria e Bashkuar<sup>100</sup>.

<sup>99</sup> *Deweer kundër Belgjikës*, A-35, 27 shkurt 1980, parag. 46.

<sup>100</sup> *Rasti X kundër Mbretëria e Bashkuar nr. 5076/71 CD 64 në 67 (1972)*. Në atë rast mbrojtjet adekuate u konsideruan të jenë në pajtim me nenin 6 (1) dhe ishin për rastin kur gjykatësi ishte i kënaqur se i akuzuari kuptonte efektin e deklarimit të tij dhe se rrëfimi i tij po regjistrohet.



### PJESA 3

## UDHËZIME MBI MARRËVESHJEN PËR PRANIM TË FAJIT

### 1. HYRJE

Ligji i ri mbi procedurën penale (LPP) ka futur në zbatim procedura dhe mekanizma të reja që zënë fill nga sistemi adversar, ndër të cilat edhe mundësia e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Kjo marrëveshje është një ujdë – varësisht nga aprovimi i gjykatësit – lidhur me akuzat për një aktvendim të fajësisë dhe dënimit, që rregullohet nga kapitulli 29. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nuk është më shumë sesa një proces negociatash, qëllimi i të cilit është të bind prokurorin të heq dorë ose të zvogëlojë akuzat dhe të pajtohet për një dënim të favorshëm për të akuzuarin, të cilën gjë edhe gjykatësi i lëndës (në tekstin e mëposhtëm gjykatësi) do të duhet ta pranojë.<sup>101</sup> Në thelb, qëllimi i marrëveshjes mbi fajësinë është të zgjidhet lënda nëpërmjet një procedure më të shkurtër: në këmbim të të mosshkuarit përmes një gjykimi që konsumon edhe kohë edhe resurse, i akuzuari dakordohet, me *dijeninë* e vet dhe *vullnetarisht* të pranojë këtë marrëveshje, duke kuptuar se ai/ajo do të fitojë një dënim më të favorshëm sesa të shkohet përmes seancave gjyqësore. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është e mundur vetëm pas fillimit të hetimit, kur prokurori ka “dyshime të bazuara” se një person ka kryer vepër penale,<sup>102</sup> por para fillimit të shqyrtimit fillestar të të akuzuarit.<sup>103</sup> Meqë i akuzuari ka heshtur<sup>104</sup> dhe ka qenë pa avokat mbrojtës për lëndën<sup>105</sup>, kjo i ndihmon marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Sipas disa traditave juridike, është e mundur të hiqen akuzat pavarësisht nga provat. Kjo në përgjithësi pranohet në sistemin e Ligjit të përbashkët ku barra e provave qëndron plotësisht mbi prokurorin. Mirëpo, kjo qasje në përgjithësi nuk

<sup>101</sup> *Shih* Nenin 39(2), i cili e obligon dhe i jep të drejtë prokurorit “të bëjë negociata dhe marrëveshje me të pandehurin lidhur me marrëveshjen e fajësisë, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në këtë kod” kur krimi persekutohet ex officio.

<sup>102</sup> *Shih* Kapitullin 21 të LPP-së.

<sup>103</sup> *Shih* Kapitullin 22 të LPP-së. *Shih* poashtu Nenin 206(1)(2).

<sup>104</sup> *Shih* Nenin 69(2).

<sup>105</sup> *Shih* Nenin 79.



pranohet në sistemin e Ligjit civil, ku barra e bindjes qëndron mbi gjykatësin i cili është i obliguar të gjejë të vërtetën objektive. Rrjedhimisht, në sistemin e Ligjit civil – në Republikën e Maqedonisë – mundësitë për marrëveshjen e fajësisë janë të kufizuara në marrëveshjen e dënimit, sepse do të ishte negative ndaj sistemit penal maqedonas që gjykatësi të injorohë faktet dhe mos t'i përfill detyrimet e tij/saj gjatë kërimit të së vërtetës.<sup>106</sup> Pasi u tha kjo, në disa rrethana faktike, mund të ekzistojë mundësia që të bindet prokurori se është në interes të drejtësisë të hiqet dorë nga disa akuza në bazë të asaj se, edhe përkundër vlerësimit të tij/saj fillestar të provave, shqyrtimi i mëtejshëm tregon se ato akuza duhet braktisur për shkak të provave të pamjaftueshme. Në çdo rast, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për ligjin penal apo atë civil, varet nga gjykatësi se a do ta pranojë, ndryshojë apo refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Kështu, qëllimi i marrëveshjes së fajësisë nuk është vetëm të bindet prokurori të ofrojë ndonjë marrëveshje të favorshme, por edhe të sigurohet se kjo marrëveshje është e pranueshme edhe për gjykatësin i cili do të duhet të vendos.

S'ka asgjë magjike lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Procesi është i njëjtë si me arritjen e ujdisë për një çmim të volitshëm për ndonjë produkt në treg. Me fjalë të tjera, ka të bëjë me arritjen e pazarit: sa kohë do të duhet të kalohet në burg i akuzuari si rekomandim që gjykatësi ta pranojë. Mund të ketë raste kur, duke u bazuar në prova të reja ose gabime të bëra me përcaktimin e akuzave, mund të bëhen përshtatje të akuzave aktuale që t'u reflektojnë më së miri fakteve dhe kërkesave të kodit penal. Në raste të tilla, një pjesë e procesit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë do të përfshijë diskutime vallë mund të bëhen përshtatjet e tilla të akuzave në mënyrë të duhur. Këtu nuk bëhet fjalë për zhdukjen e krimeve të bëra, por thjesht bëhen përshtatje të nevojshme dhe të arsyeshme të akuzave që t'i përshtaten ligjit dhe fakteve të lëndës.

Në shumicën e rasteve prokurori nuk do të dëshirojë të pajtohet për kohëzgjatjen e ndonjë dënimi, por do të pajtohet për një seri kohësh (propozim dënime) për të cilat gjykatësi do të caktonte dënimin e duhur. Sipas këtij skenari, qasja e përgjithshme është të arrihet pajtim i përbashkët për serinë e kohës: në njërin anë “minimumi absolut i pranueshëm” për të cilën do të pajtohet prokurori si dënim, por të diskutohet edhe nga avokati i mbrojtjes, dhe në anën tjetër “maksimumi absolut i pranueshëm” për të cilën do të pajtohet avokati i mbrojtjes, por të diskutohet edhe me prokurorin. Qasja e

<sup>106</sup> *Shih* Nenin 484, i cili thekson se lënda e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë është tipi dhe kohëzgjatja e sanksionimit, dhe nëse pranohet nga i Akuzuari lidhur me dëmshpërblimin juridik apo pronësor të palës së dëmtuar.

serisë (në të cilën ka kufi të largët dhe të afërt) është ndoshta qasja më fleksibile për të dyja palët.

Edhe pse s'ka garanci se gjykatësi do të japë dënim sipas propozimeve të të dyja palëve, ekziston një probabilitet i mirë që gjykatësi të pranojë propozimin. Gjykatësit janë të pavarur dhe, siç dihet, ata kënaqin të drejtën e tyre për të ushtruar autoritetin e tyre në mënyrë të pavarur. Kështu, duke i ofruar gjykatësit një propozim të arsyeshëm nga i cili do të vendos, gjykatësi ka liri të përcaktohet dhe të zgjidh lëndën ose të braktis propozimin dhe të rrezikojë që palët të heqin dorë nga marrëveshja e fajësisë dhe të shkojnë me lëndën e tyre në gjyq. Këtij skenari të fundit gjykatësit duan t'i shmangen: nuk ka kuptim të humbet kohë e vlefshme gjyqësore duke zhvilluar një proces të tërë kur një seancë e shkurtë dëgjimore do t'i jepte rezultatet e pranueshme.

Gjykatësit e fazës preliminare nuk mund të marrin pjesë në procedurën e marrëveshjes mbi fajësinë midis prokurorit dhe avokatit.<sup>107</sup> Pasi të dorëzohet propozimi i marrëveshjes mbi fajësinë në pajtueshmëri me nenin 335, gjykatësi ka për obligim të caktojë seancë dëgjimore në pajtueshmëri me nenin 488. Gjykatësi mund të sjell vendim ose të pranojë propozimin sipas kushteve të nenit 490, ose të refuzojë në bazë të nenit 489. Nëse pranohet marrëveshja e fajësisë, të dyja palët kanë të drejtë të apelojnë për vendimin.<sup>108</sup>

## 2. PROCESI I MARRËVESHJES MBI PRANIMIN E FAJËSISË

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është detyrë e rëndësishme për avokatin e mbrojtjes. Ndoshta duket se është në favor të prokurorisë të arrihet një dënim i lehtë pa mos u angazhuar në një gjykim të gjatë, por avokati i mbrojtjes e ka detyrën më të vështirë për arritjen e rezultatit më të favorshëm për klientin, pa mos u deshtë të shkojë në gjykim dhe të rrezikojë dënim të rëndë. Si avokat i mbrojtjes, pikësynimi është të fitojë rezultatin më të mirë për klientin. Meqë çdo lëndë ka faktet e veta dhe sfidat e veta, nuk ka formulë të veçantë: e gjithë kjo varet nga prokurori i involvuar, nga përparësitë dhe mangësitë e lëndës së prokurorisë, nga natyra e akuzave, nga natyra e fakteve, nga historia e palëve (të akuzuarit dhe viktimat), nga gjykatësi i involvuar, nga vendi ku ka ndodhur krimi i supozuar, si dhe vendi ku gjykohet krimi. Këto faktorë janë jashtë kontrollit të avokatit të mbrojtjes. Si të tilla, ato përbëjnë

<sup>107</sup> *Shih* Nenin 487.

<sup>108</sup> *See* Article 488(5).

*faktet që s'ndryshohen.* Mund të debatohet se ndonjë prokuror ose gjykatës nuk duhet të involvohet për shkak të konfliktit të interesit, por përveç kësaj, nuk mund të bëhet shumë për këtë gjë vetëm se të pranohen këto fakte dhe të shihet se deri në çfarë mase mund të shfrytëzohen ato për të fituar një marrëveshje ideale për pranimin e fajësisë. Sidoqoftë, avokati i mbrojtjes duhet të fillojë – ashtu sikur e bën punën e përditshme gjatë përgatitjes së lëndës – me analizën e lëndës dhe ta bëjë distilimin e saj, të përcaktojë çfarë detyrash hetimore duhet kryer, t'i analizojë përparësitë dhe mangësitë e lëndës së prokurorit etj. Në thelb, lënda duhet analizuar njësoj sikur të shkojë në gjykim. Vetëm me përgatitje të hollësishme të lëndës për gjykim, avokati do të duhet të pajiset me njohuri të mjaftueshme për të bërë një vlerësim inteligjent të lëndës, dhe të jetë në pozitë të këshillon klientin e tij/saj siç duhet se a duhet ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë apo jo.

Çdo gjë që pason në një procedurë penale që ka elementet e sistemit adversar, siç është e drejta e grumbullimit të provave, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe iniciimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, bazohet gati plotësisht në identifikimin dhe përcaktimin e *teorisë* më të favorshme të *rastit*.<sup>109</sup> Edhe pse kuptohet se jo çdo rast – për shkak të *fakteve të pandryshuara* - do të rezultojë në ndonjë *teori të rastit* që siguron lirimin absolut, shumica e rasteve janë të përshtatshme për të arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Mirëpo, në bazë të këtyre fakteve vlen të theksohet se *marrëveshja mbi pranimin e fajësisë*, si e tillë, nuk është *teori e rastit*. Edhe pse faktet e lëndës mund të jenë të përshtatshme për të arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë – sepse do të duket më e përshtatshme të kërkohet ndonjë shërbim më herët te gjykatësi – prapëseprapë duhet të mendohet *teoria e rastit*, nëse jo për shkaqe tjera por për shkakun nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nuk arrihet, atëherë të përgatitet lënda për në gjykim.

Pasi të analizohet në hollësi lënda dhe hetimet e mundshme janë përfunduar, secila palë duhet të ketë sens nëse rasti duhet të *gjykohet*, gjegjësisht rreziku i daljes në gjyq, ose mund të *negociohet*, gjegjësisht, vlen të ndiqet me seriozitet marrëveshja për pranimin e fajësisë. Përgjigja është se varet nga lënda: faktet do të diktojnë drejtimin se në cilën kategori bën pjesë lënda –

<sup>109</sup> *Teoria e rastit* nuk është kurrëgjë më tepër sesa një tregim logjik bindës për atë se çka ka ndodhur nga pikëpamja e prokurorit/mbrojtjes. Kjo është një “arsyetim”, “justifikim” ose “shpjegim”, për atë se pse duhet prokuroria ose mbrojtja të ngadhënjëjnë në gjyq. Teoria e rastit duhet të zhvillohet në mënyrë logjike dhe të vazhdueshme, që pasi të shqyrtohen provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve, trupi gjykues të marrë vendim në mënyrë racionale në favorin tuaj.

edhe pse do të nevojitet një shkallë e caktuar e objektivitetit: me rëndësi është të jemi realë, çdoherë të kemi parasysh interesin më të mirë për klientin tonë.

Ashtu siç ndodh në çdo juridiksion tjetër, vendimi i fundit se a duhet iniciuar marrëveshje për pranimin e fajësisë, dhe nëse po, a duhet pranuar oferta e fundit e prokurorit, qëndron mbi përgjegjësinë e të akuzuarit - klientit.<sup>110</sup> Kjo është shumë e rëndësishme që avokati i mbrojtjes ta kuptojë dhe t'i përmbahet kësaj për secilën lëndë. Si e tillë, para se avokati i mbrojtjes t'i afrohet prokurorit për të konsideruar mundësinë e marrëveshjes së pranimi të fajësisë, ai duhet të marrë pëlqimin e klientit. Duke e bërë këtë – ose për ta precizuar edhe më shumë, me qëllim që klienti të jetë në pozitë të japë autorizim të informuar – avokati i mbrojtjes ë duhet t'i sqarojë klientit këtë që vijon:

- çka është marrëveshja mbi pranimin e fajësisë;
- si funksionon marrëveshja mbi pranimin e fajësisë;
- përparësitë dhe mangësitë e pranimi të marrëveshjes së fajësisë;
- anët e forta dhe të dobëta të lëndës; dhe
- rreziqet e të shkuarit në gjyq kundrejt zgjidhjes së lëndës nëpërmjet marrëveshjes së fajësisë.

Gjatë këtij këshillimi me klientin avokati i mbrojtjes duhet të sqarojë procesin me anë të së cilit ai/ajo do të angazhohet për të fituar ndonjë marrëveshje për pranimin e fajësisë. Klienti duhet të sigurohet se çdo ofertë e bërë nga prokurori duhet t'i përcillet atij dhe asnjë kundërofertë s'duhet t'i ofrohet prokurorit pa dijeninë dhe aprovimin e klientit. Me fjalë tjera, avokati i mbrojtjes e merr përgjegjësinë për të siguruar se asgjë s'do të ndodhë pa dijeninë dhe pa aprovimin e klientit. Me të vërtetë, për qëllime të praktikës së mirë, rekomandohet të përpilohet një memorandum i standardizuar dhe t'i jepet klientit me qëllim që ai/ajo më konkretisht të kuptojnë procesin hap pas hapi të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Më tutje, kur jepen oferta nga prokurori, më mirë është ato oferta të jepen në formë të shkruar dhe t'i prezantohen klientit. Po ashtu, edhe kundër-ofertat duhet të jenë në formë të shkruar dhe të bëhen pjesë e lëndës. Edhe pse kjo mund të marrë kohë, me rëndësi është të mbahet evidence transparente në rast se lind ndonjë pyetje lidhur me atë se çka është ofruar, kundër-ofruar, refuzuar, pranuar etj.<sup>111</sup>

<sup>110</sup> *Shih* Nenin 206(6), sipas të cilit “Para fillimit të shqyrtimit fillestar, i pandehuri do të njoftohet edhe për të drejtën e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me prokurorin publik, në pajtueshmëri me nenin 489 deri në nenin 496 të këtij kodi.”

<sup>111</sup> *Shih* Nenin 89(1), i cili thekson se “Për çdo veprim të ndërmarrë gjatë procedurës penale përpilohet procesverbal në të njëjtën kohë kur ndërmerret veprimi, e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë menjëherë pas kësaj.”

Në disa juridiksione, ku lejohet të arrihet marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, nga prokurori pritët të sigurohet një njoftim për dëshmitarin e palës ankuese /viktimën. Kjo nuk nënkupton se prokurori duhet të kërkojë dhe të marrë leje nga dëshmitari/viktima para se të arrihet ndonjë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Po ashtu është zakon të informohet dëshmitari/viktima se kur është caktuar data e seancës dëgjimore për marrëveshjen e fajësisë dhe t'u dërgojë ftesë për praninë e tyre dhe dhënien e deklaratës në gjyq. Natyrisht, në disa raste, do të jetë e nevojshme për dëshmitarin ankuesin/viktimën të jetë prezent dhe të japë dëshmi gjatë seancës dëgjimore për marrëveshjen e fajësisë, sidomos kur bëhet fjalë për çështje dëmshpërblimi (të përcaktohen dëmet e sakta financiare /pronësore si pasojë drejtpërdrejtë apo e tërthortë e veprave penale të të akuzuarit). Për qëllime përgjegjësie dhe transparence rekomandohet që prokurori të njoftojë dëshmitarin ankues/viktimën e procesit për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Kontributi i dëshmitarit ankues/viktimës është i dobishëm për kryerjen e vlerësimit për atë se çfarë dënimi do të jetë i pranueshëm. Kjo po ashtu i mundëson edhe palës ankuese/viktimës të jetë pjesë e procesit.

Për sa i përket vet procesit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ajo fillon duke pasur në dispozicion një dënim të caktuar i cili është i pranueshëm për klientin dhe mjaft real për gjykatësin, që ai ta pranojë. Përcaktimi i dënimit, siç u diskutua edhe më lart, varet nga disa faktorë. Së pari, duhet bërë një hetim që të zbulohet se a ka raste të njohura me fakte dhe akuza të ngjashme nga dhe përreth juridiksionit të krimeve të supozuara, gjatë të cilave dënimet e dhëna do të mund të shërbenin si model në lëndën e klientit: si një mënyrë e vendosjes së pikënisjes adekuate. Kjo kërkon hulumtim themelor, sidomos nëse avokati i mbrojtjes nuk e kryen praktikën e tij rregullisht para gjyqit të caktuar. Në rrethana të tilla, mënyra më e shpejtë për gjetjen e atyre informatave është të kontaktohen anëtarët lokal të dhomës penale të avokatëve në atë vend. Me të vërtetë, kjo mund të jetë e dobishme edhe për përfitimin e njohurive për tiparet e prokurorit dhe të gjykatësit të involvuar në atë lëndë të caktuar: sa më shumë informata, aq më mirë. Meqenëse asnjë lëndë nuk është gjykuar në abstrakt, është me rëndësi të çmohet rrethi në të cilin punojnë dhe veprojnë vendim-marrësit e fundit. Prokurori duhet të jetë fleksibël ndaj lëndës dhe të pranojë se do të humbë dobinë nga gjykimi publik, kurse gjykatësi vetëm do të jetë i gatshëm për të pranuar ndonjë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë nëse popullata vendore, ku bëhet gjykimi, do të jetë e kënaqur me zgjidhjen përfundimtare të problemit.

**Arritja e: po - po - po**

Derisa arritja e ujdisë në treg mund të jetë një proces i instinktit, duke filluar nga anë të kundërta të negociatave derisa njëra palë të dorëzohet dhe pranon, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, nëse kryhet me seriozitet, është pak më shumë e sofistikuar. Meqë pikësynimi është të arrihet një situatë fitore-fitore (të dyja palët të fitojnë), gjegjësisht të fitohet një marrëveshje (dënim) e cila:

- a. do të kënaq edhe klientin edhe prokurorin; dhe
- b. është e drejtë dhe e arsyeshme për viktimën (dhe për interesat e shoqërisë), pikënisja s'duhet të jetë shumë e ulët për t'iu kundërvënë ofertës së lartë të prokurorit.

Hapi i parë në procesin e negociatave është të identifikohen pikësynimet e involvuara: të shihet cili është dënimi më adekuat dhe më i pranueshëm për klientin (pikësynimet e klientit), dhe ajo më e rëndësishmja, të shihe se cilat janë nevojat konkrete të prokurorit të cilat ajo/ai duhet t'i plotësojë me këtë lëndë në bazë të fakteve të caktuara dhe rrethanave (pikësynimeve të prokurorit). Mbasi të identifikohen pikësynimet, atëherë kërkohet të gjendet një qasje kreative që *pak a shumë* do t'i kënaqte këto pikësynime. Kjo kërkon që të shqyrtohen realisht të gjithë faktorët e involvuar dhe sidomos të pranohen kufizimet të cilat mund të ngarkojnë prokurorin – për të ofruar zgjidhje. Duke pranuar çfarëdo dilemë, prokurori mund të tregojë butësi ndaj lëndës (që do të ishte perceptimi i përgjithshëm i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë), avokati i mbrojtjes, është në pozitë më të mirë për të gjetur zgjidhje kreative. Më tutje, duke i diskutuar faktet e lëndës me prokurorin, duke përfshirë këtu edhe ato elemente të cilat s'do të jenë të thjeshta apo të lehta për t'u vërtetuar, avokati i mbrojtjes i thekson përfitimet e arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Me të vërtetë, nga pikëpamja strategjike, është me rëndësi të futet prokurori në diskutime ku ai/ajo do të zbulojë çfarëdo shqetësimesh ose kufizimesh të caktuara lidhur me lëndën – ndryshe nga ato që janë evidente nga faktet e lëndës. Ky lloj informacioni është i rëndësishëm, jo vetëm për zbulimin e argumenteve për negociatat e marrëveshjes së fajësisë, por edhe për t'u përgatitur për gjykim.

Gjatë identifikimit të dilemave të prokurorit, avokati i mbrojtjes po ashtu s'duhet t'i anashkalojë edhe kufizimet e mundshme për gjykatësin i cili duhet të pranojë apo refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ose të mbajë

